



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Raporti Gjashtëmuor
Janar-Qershor 2024

KORRIK, 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Data / Date /Datum:	18.06.2024
Për / To / Za:	Zyrës së Kryetarit
Nga / From /Od:	Drejtoria për Administratë
Lënda / Subject / Tema:	Raport i punës 03 Janar - 31 Maj 2024

RAPORT I PUNËS

Në këtë drejtori veprojnë 8 Sektore:

1. Gjendja Civile
2. Qendra për shërbim të qytetarëve
3. Ligjor
4. Përkthim dhe Lekturim
5. Teknologji Informative
6. Logjistikë
7. Mjete themelore (pasurisë komunale)
8. Arkiva

*Te gjitha lëndët e Drejtorisë për Administratë janë 0 (zero), të përfunduara me kohë, zgjidhje e tyre në afate rekorde, përgjigje e shpejtë palëve, totali i lëndëve të Komunës janë: **42.982** kurse vetëm nga Drejtoria për Administratë janë: **26.679** apo me përqindje në nivel të përgjithshëm Komunal, vetëm Drejtoria e Administratës ka **62.07 %** të lëndëve.*

Nga Drejtoria për Administratë janë realizuar këto punë dhe projekte:

- 1. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativë*
- 2. Furnizim me kompjuterë*
- 3. Mirëmbajtja e kamerave të qytetit*
- 4. Furnizim me material Administrativ për nevojat e SHCK-së*
- 5. Furnizim me material elektrik për SHCK*
- 6. Furnizim me artikuj për mirëmbajtjen e objekteve*
- 7. Servisimi (Mirëmbajtja) e automjeteve*
- 8. Furnizim me naftë për nxehe*
- 9. Furnizim me naftë për veturat zyrtare*

Vendosja e te dhënave sipas raporteve nga Sektorët:

Bazuar në raportet e dërguara nga udhëheqësit e sektorëve në Drejtorinë e Administratës, raporti i punës për periudhën 03 Janar - 31 Maj 2024 është si vijon:

1. SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Ka kryer këto shërbime :

1.Vendime për regjistrim me vonesë ne RTHL	17
2.Vendime për regjistrim me vonesë në RTHV	60
3.Vendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	48
4.Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	56
5.Regjistrime në RTHL-ve	722
6.Regjistrime në RTHV-ve	430
7.Regjistrime në RTHM-ve	376
8.Lëshuar certifikata të lindjes	9338
9.Lëshuar ekstrakte të lindjes	23040
10.Lëshuar certifikata të kurorëzimeve	4989
11.Lëshuar certifikata të vdekjes	2435
12.Lëshuar certifikata të statusit martesor	1040
13.Lëshuar certifikata të vendbanimit	2746
14.Lëshuar certifikata të shtetësisë	358
15.Lëshuar deklarata të Bashkësisë Familjare	1856
16.Lëshuar vërtetime nga Arkiva	646
17.Raporte për lindje statistikës DEM-1	722
18.Raporte për vdekje statistikës DEM-2	430
19.Raporte për kurora statistikës DEM-3	376
20.Aplikime për tu liruar nga shtetësia e Kosovës	21
21.Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	60
Gjithsej shërbime të kryera:	49.766

Janë realizuar taksa nga zyrtaret:	52.436,00 Euro.
---	------------------------

Vërejtje: Në raport janë të përfshira shërbimet nga data 03.01 deri me datë 31.05.2024.

2. QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

Kjo qendër ka pranuar gjithsej 42.982 kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në drejtori të ndryshme sipas tabelës së më poshtme:

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

03/01/202 - 31/05/2024

Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
Drejtorja për Administratë	0	0	3,268	53	4	1	0	21	23,332	26,679
Drejtorja për Arsim	0	10	1,189	0	0	0	0	73	0	1,272
Kuvendi Komunal	0	6	19	0	0	0	0	1	0	26
Drejtorja për Buxhet dhe Financa	56	199	1,910	16	0	0	0	4	0	2,185
Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport	0	149	42	3	0	1	0	0	0	195
Drejtorja për Mirëqenie Sociale	0	30	0	0	0	0	0	0	0	30
Drejtorja për Shëndetësi	6	232	172	0	3	0	0	4	0	417
Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	1	80	432	77	4	101	1	15	0	711
Kryetari i Komunës	2	51	960	8	0	90	5	6	0	1,122
Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	1	149	47	2	0	0	0	0	0	199
Drejtorja për Kadastër dhe Gjeodezi	14	1,405	6,691	0	0	0	0	33	0	8,143
Drejtorja për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	0	37	188	73	1	0	1	1	0	301
Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim	0	34	10	0	0	0	0	0	0	44
Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	0	613	180	3	0	0	0	3	0	799
Drejtorja për Punë Inspektuese	1	312	6	0	0	0	0	0	0	319
Drejtorja për çështje Pronësores-Juridike	0	282	196	4	1	0	0	4	0	487
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Prokurimi	0	52	0	0	0	0	0	0	0	52
	81	3,641	15,311	239	13	193	7	165	23,332	42,982

Në Qendrën për Shërbim të qytetarëve kanë kaluar lëndë nga te gjitha Drejtoritë, lëndët nga Drejtorja për Administratë janë aprovuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Administratë.

3. ZYRA LIGJORE KOMUNALE

Gjatë periudhës gjashtë (6) mujore konkretisht **03.janar-31 MaJ për vitin 2024**, në zyrën ligjore ka kryer këto aktivitete të cilat po i paraqesim si në vijim:

1. Ofrimi i ndihmës juridike për Komision Disiplinor në lidhje me rastin e zyrtares së DKRS-së H.H për dyshimin e bazuar për shkeljen disiplinore.
2. Se bashku me Udhëheqësin e Personelit është shqyrtuar shkresa/Njoftimi i Prokurorisë Themelore në Pejë lidhur me pezullimin e zyrtareve publike që janë ngritur aktakuzat për veprat penale **“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**. Baza ligjore e pezullimit të zyrtarëve publike parashikohet në nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 ndërlidhur me nenin 71 paragrafi 8 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publik (GZ e RK nr.21 dt.18 shtator 2023).
3. Në bashkëveprim me Menaxherin për Njësinë e Personelit është shqyrtuar dhe vendosur kërkesa për transferim nëpunëses civile H.H e ushtruar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë Drejtoresha e DKRS, kërkesa është vendosur me Vendim për transferim e nëpunëses civil H.H .
4. Më kërkesë të inspektorëve të ambientit janë konsultuar në aspektin juridike lidhur formën dhe përmbajtjen formale të formularit për shqiptimin e gjobës administrative.
5. Anëtar i Komisioni për Planin e Integritetit.
6. Në cilësi të anëtarit të Komisioni për rekrutim për pozitën e Zyrtar për Barazi Gjimore kamë marrë pjesë në testin me gojë dhe zbatimin e procedurave administrative rekrutuese.
7. Me kërkesë të Kryetarit të Komunës është kërkuar interpretimi i Marrëveshjes për Bartjen e Kompetencave për Themelimin e Inkubatorëve të Biznesit.
8. Me datë 16 prill 2024 kamë marrë pjesë në punëtorin të organizuar nga USAID lidhur me procedurat standarde e operimit për procedurat disiplinore.
9. Sipas kërkesë se juaj të parashtruar me dt.04 prill 2024 është bërë harmonizimi i Rregullës së Brendshme për menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në aspektin ligjore dhe tekniko-legjislativ.
10. Me datë 05 prill 2024 kamë marrë pjesë në punëtorin të organizuar nga USAID lidhur me procedurat standarde e operimit për procedurat disiplinore.

4. ZYRA E PËRKTHIMEVE

Zyra e përkthimeve ka kryer punën e vet në harmoni me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.

Të gjitha dokumentet që kanë ardhur për përkthim në këtë zyrë janë përkthyer, në afat, me kohë dhe pa ndonjë vonesë (dokumente dhe materiale të ndryshme nga të gjitha drejtoritë dhe zyrat, komitetet dhe organet tjera të komunës).

Prej muajit Janar gjerë në Maj 31 të vitit 2024, janë **përkthyer gjithsejtë 319 faqe material të ndryshëm, si dhe 15 orë 00 minuta** përkthime të drejtpërdrejta në takime të ndryshme. Më poshtë po japim një pasqyrë të dokumenteve kryesore dhe të vazhdueshme që janë përkthyer:

1. Procesverbalet e Kuvendit të Komunës;
2. Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Procesverbalet e Komitetit për komunitete;
4. Procesverbalet e KKSB-së;
5. Vërtetime të ndryshme;
6. Vendime dhe Aktvendime të ndryshme;
7. Konkurse të ndryshme, konkluzione, njoftime, ftesa;
8. Njoftime të ndryshme, Plane dhe strategji;
9. Projektet të ndryshme.

5. SHËRBIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Janë kryer punë të përditshme, dhe është raportuar çdo ditë pune, numri i kërkesave të realizuara është: **962** Kërkesa.

Bazuar në kërkesat tjera për menaxhim dhe implementim, me poshtë gjeni të dhënat:

- Laura menaxhimi i bazës së të dhënave nga Sektori për TI-ve.
- Zyrtarët nga sektori i TI-ve, Pjesëmarrje në shumë Komisione, takime të ndryshme, punëtori dhe konsulta.
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e Sektorit.
- Menaxhimi i bazave të dhënave lokale të krijuara me zero kosto.
- Menaxhimi i bazave të dhënave nga ASHI.
- Menaxhimi i e-kioskut
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për Teknologji Informativ - Kompjuterëve
Për raport me të detajuar dorëzohet aneksi i veçantë të Drejtoresha e Drejtorisë

6. SHËRBIMI I LOGJISTIKËS SË KOMUNËS

- Mirëmbajtja e objekteve komunale
- Mbikëqyrja e pastrimit të objekteve dhe furnizimi me material të pastrimit
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e nxehtësisë qendrore si dhe furnizimi me lëndë djegëse
- Mirëmbajtja e veturave dhe servisimi i tyre
- Lyerja dhe rregullimi i 6-shtë zyrave në ndërtesën kryesore
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik
- Rregullimin dhe servisimin e gjeneratorit në ndërtesën kryesore pas djegies së instalimit dhe aparaturave elektronike
- Rregullimi i nxehtësisë qendrore në ndërtesën e arsimit
- Rregullimi i njeve sanitare në ndërtesën e Administratës
- Regjistrimin e automjeteve të reja (15 veturave)
- Furnizimi me material hargjues për të gjitha drejtoritë
- Pranimin e mallit si zyrtarë alternativ për pagesa për të gjitha drejtoritë deri në pranimin e zyrtarit të ri
- Furnizimi me material shpenzues për nevojat e të gjitha drejtorive
- Menaxhimi i punëtorëve për mirëmbajtje të ndriçimit publik
- Përgatitja e lendeve për pagesë nga Drejtoria e Administratës.
- Bartja e arkives të Urbanizmit në arkivin e re të Administratës.
- Punët e kryera në urën të sharrës, bartja dhe pastrimi i mbeturinave .

7. ZYRA E MJETEVE THEMELORE(PASURISË KOMUNALE DHE E-PASURIA

- Bartja e obligimeve te mbetura nga viti paraparak, si dhe kryerja e të gjitha obligimeve te shpenzimeve komunale pas alokimit te buxhetit.
- Kryerja e pagave për “Eko- Sig”,për Shërbimet Teknike dhe Mirëmbajtja si dhe Sigurimi Fizik.
- Shpenzimet e rrymës për periudhën dhjetor’23-maj’24
- Shpenzimet e ujit për periudhën dhjetor’23-maj’24
- Shpenzimet e telefonisë fikse për periudhën dhjetor’23-maj’24
- Shpenzimet e mbeturinave për periudhën dhjetor’23-maj’24

Shpenzimet e rrymës me vendim te Kryetarit për:


- Pompat e ujit Vranoc, për periudhën dhjetor’23-maj’24
 - Radio Peja për periudhën dhjetor’23-maj’24
 - Gorazhdeci, për periudhën dhjetor’23-maj’24
 - KK-Access Action Program (zyra e turizmit afër patrikanës),
 - Tel.Mobil-Vala, për dhjetor’23-maj’24
 - Shpenzimet postare dhjetor’23-maj’24
 - Pagesat për kyçje te rrymës për Shtëpinë e Fshatit-Dubovë,
 - Pagesa e rrymës për Pompat e ujit ne lagjen “Asllan Qeshme”,për kyçje.
 - Regjistrimi i lendeve në sistem e-Pasuria,(regjistrimi i materialit shpenzues), si dhe realizimi i kërkesave të zyrtareve për furnizim me material shpenzues për të gjitha drejtorit.
 - Regjistrimi i aseteve ne sistemin e-Pasuria (nxjerrja e barkodeve) ngarkimi dhe transferet sipas kërkesave.
 - Evidentimi i shpenzimeve komunale ne databazen e shpenzimeve,
 - Barazimi i pagesave me kompanitë:”KESCO”,”AMBIENTI” si dhe “HIDRODRINI”
 - nxjerrja e barkodeve për drejtorin e Shëndetësisë, dhe Arsimit.
- Punë tjera sipas kërkesave.

8. SEKTORI I ARKIVËS

- Njësia e Arkivës në periudhën kohore i ka kryer të gjitha detyrat e punës të cilat janë në përgjegjësi dhe fushëveprim i kësaj zyre.
- Zyra e Arkivit e Komunës së Pejës ka kryer punët duke u përkujdesur në zbatimin e ligjeve të aprovuara dhe harmonizimi i akteve të ndryshme me Ligjin Nr04/L-088 për Arkivat Shtetërore ,Ligjit Nr.04/L- 184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe të Rregullores MAP Nr. 01\2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afateve e ruajtjes së tyre.
- Gjatë këtij 9 mujori jemi munduar për ti arritur këto objektiva të cilat edhe i përcakton vendi i punës,
- Siç janë detyrat për pranimin ,evidentimin dhe kontrollimin radhitjen e lendeve ,akteve, klasifikimin dhe arkivimin ,ruajtjen dhe mbajtjen e evidencës e lende arkivore ,ndarjen e materialit dhe kemi përcjelle edhe afatin ligjor të ruajtjes së tyre .
- 1.Jane Pranuar Kërkesa për Kopje nga Origjinale drejtuar Zyrës së Arkivit
- Gjithsejte :Kërkesa 180
- 2.Jane Pranuar Ankesa dhe Kërkesa nga Drejtorati për Financa nga Zyra e Tatimit ne Prone Gjithsejtë: Ankesa 467 /2024
- 3.Jane Arkivuar këto Lende nga gjendje Civile të vitit 2023
- Gjithsejtë :1.Aktet Lindjes të Rregullta2.Aktet Martesave të Botës së Jashtme 3.Aktet Vdekjes te Rregullta4.Vendimet për Korrigjime
- Gjithashtu gjate periudhës 6 mujore Zyra për Arkivimin e Lëndëve ka ruajtur në mënyrë elektronike materialin arkivor përmes ose duke e përdorur Sistemin për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve SMAED duke e menaxhuar këtë sistem kemi arkivuar/ruajtur lëndët më rëndësi dhe i kemi anuluar ato të cilat kane më pak rëndës për arkivim /ruajtje.
- Gjatë këtij viti në Sistemin për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik te Dokumenteve SMAED janë menaxhuar në total 35.000 Lëndë nga të gjitha Drejtorit e Komunës së Pejës.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama

Drejtoria Komunale e Arsimit- Nr.prot. _____ Naser gega Naser gega@rks-gov.net 044-221-164	 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJË	PERIUDHA RAPORTUESE
		JANAR --qershor
		DATA: 20.06.2024

Nr. Ref.	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës duhet të behën sipas planit të prokurimit, bazuar ne buxhetin e parapare për investime kapitale për vitin 2022	Muaji i realizimit përfshirë edhe procedurën e prokurimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1.	FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE-DRU DHE PELET	SHKURT	340,000.00
2.	BLERJA E KOMPJUTERËVE DHE PAISJEVE PËRCJELLËSE PËR SHKOLLA	PRILL	20,000.00
3.	OFRIMI I SIGURIMEVE AKSIDENTALE PER NXËNËSIT E SHKOLLAVE	PRILL	3,500.00
4.	FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK DHE USHQIMOR	PRILL	145,000.00
5.	RREGULLIMI I KABINETEVE NË SHFMU “ 8MARS ” , “ LIDHJA E PRIZRENIT ” , “ V.P.SHKODRANI ” DHE “ SMAJL HAJDARAJ”	PRILL	70,000.00
6.	NDËRTIMI I SALLËS NË FSHATIN TREBOVIQ	SHKURT	175,000.00
7.	NDËRTIMI I SALLËS NË FSHATIN GLLOGJAN	SHKURT	175,000.00
8.	NDËRTIMI I OBJEKTIT TË GJIMNAZIT SHKENCOR	SHKURT	2,981,010.38
9.	NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS “28 NËNTORI”-ZLLAPEK	SHKURT	
10.	NDËRTIMI I ANKESIT NË SHKOLLËN “RILINDJA” DHE RENOVIMI I NGROHJES QENDRORE NE IAAP “RIFAT GJOTA”	PRILL	112,071.22

Drejtoria Komunale e Arsimit ka për qëllim krijimin e kushteve për edukim cilësor të të gjithë nxënësve dhe avancim të vazhdueshëm profesional të mësimeve në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

Në Komunën e Pejëv vijojnë mësimin 15619 nxënës në 26 shkolla fillore të mesme të ulta ,në 6 shkolla të mesme të larta . Në tri objekte funksionon IP “ Pëllumbat e Paqes ”me 395

fëmijë.

Në mësimdhënie janë të përfshirë 1450 mësimdhënës prej të cilëve 931 femra dhe 519 meshkuj.

Gjatë periudhës së gjashtë mujorit të parë në sektorin e arsimit janë realizuar këto detyra:

- Takim i drejtorit të DKA-së me drejtorët e shkollave - përgaditjet e shkollave për fillimin e periudhës të dytë të vitit shkollor 2023/2024.(30 janar 2024)
- Vlerësimi i punës së stafit të DKA-së gjatë vitit 2023-janar
- Përpilimi i listave të nxënësve nga komuniteti boshnjak lidhur me regjistrimin dhe vijueshmërinë e nxënësve në shkolla-JANAR
- Organizimi dhe mbajtja e mësimit shtesë për nxënës të riatëdhesuar -janar-qershor
- Punëtori për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Parandalim të Braktisjes dhe Mosregjistrim në Shkolla -janar ,vazhdon
- Trajnimi i edukatoreve për pilotimin e Kurrikulës së Re -janar-vazhdon
- Evidentimi dhe raportimi për rastet e migrimit të mësimdhënësve dhe nxënësve -në vazhdimësi
- Përzgjedhja e dy Shfmu me nxënës të kl. VII-ta nga DKA, në pjesëmarrjen e Projektit “Drejt Malit”2024,u pëzgjodhën Shfmu”7Shtatori dhe Shfmu”Tetë Marsi”-janar 2024
- Përzgjedhja e mësimdhënësit për çmimin “ Shaban Jashari ” . Çmimin e fitoj -zj.. Luljeta Kurhasani mësimdhënës në SHFMU”Lidhja e Prizrenit ” Pejë-muaji shkurt
- Shpallja e konkursit për plotësimin e vendeve të punës : 24.02.2024 (gjithsej 44 vende të shpallura)
- Punëtori me drejtor të shkollave të përgjedhura me Projektin KOSED: caktimi i datës së vlerësimit(vëzhgimit) të jashtëm të shkollës së parë nga ana e Ekipit Komunal për Vlerësim të shkollës nga kolegët-me 4.03.2024 Shfmu”Lidhja e Prizrenit”.
- Organizimi nga DKA i drekës solemne dhe shpërndarjes së mirënjohjeve për mësimdhënësit e pensionuar (nga data 7mars 2023-7 mars 2024) për nderë të 7 Marsit -ditës së Mësuesit.
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të puntorëve të rinjë(testet me shkrim,intervista ,vendimet per pranim)etj-mars 2024
- Planifikimi i Qendrave për Sistemimin e nxënësve për testin e Arritshmërisë 2024-mars 2024.
- Raportimi në SMPK për Përformancën e Komunës për vitin 2023(fusha e arsimit)- 26mars 2024

- **Shqyrtimi i ankesave të ndryshme nga shkollat (nga prindërit ,nxënësit ,drejtorët) ,nga ana e komisionit për ankesa - mars 2024**
- **Mbajtja e Ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës në bashkëpunim me DKA-në -mars 2024 , me temat :**
 - 1.Bullizmi dhe masat parandaluese // Klasat -VI—IX
 - 2. Siguria e qarkullimit të këmbësoreve në trafik //Klasat e I - VII.
- **Mbajtja e Ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës në bashkëpunim me DKA-në**
Tema: Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm // Klasat -VIII—IX- //22.04 deri 26.04.2024
- **Hapja e Qerdhes së re në Karagaq -22.04.2024**
- **Organizimi i Panairit të Edukimit me nxënës të klasave të XII-ta në sallën “1 Tetori” në Prishtinë, me dt.17.04.2024**
- **Përzgjedhja nga DKA i Ekipit të II-të Për Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave nga Kolegjet ,në Shfmu”Tetë Marsi”, data e vlerësimit 22.04.2024 deri 26.04.2024.**
- **Përgatitjet për hapjen e qerdhes së re në Vitomiricë (pranimi i inventarit)- muaji Maj**
- **Përzgjedhja nga DKA e ekipit të mësimdhënësve për trajnim nga Mashti ,Ngritja e kapaciteteve për rishikim të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm (0-9) me 11.-12.05.2024**
- **Planifikimi i DKA për regjistrim të nxënësve në klasat e X-ta për vitin shkollor 2024/25-maj 2024**
- **Inaugurimi i qendrës së re të ECCD në shfmu”28 Nëntori “ Raushiq, në kuader të projektit “ Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në Kujdesin dhe Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme në Kosovë” Save the Children”**
- **Konkursi për zv drejtor të IAAP “Rifat Gjota” dhe ShFMU”Asdreni”, edukatore për parafillor**
- **Përzgjedhja nga DKA e ekipit të mësimdhënësve për trajnim nga Mashti - Ngritja e kapaciteteve për rishikim të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm (0-9) me 11.-12.05.2024**
- **Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasën e parë –10 Maj 2024**
- **Planifikimi i “Java e Dyerve të Hapura “për nxënës të klasave të nënta –vizitë shkollave të mesme dhe promovim i tri profesionale shkollave në qendër të qytetit - 20-24 maj 2024**
- **Raportime në MASHTI lidhur me numrin e nxënësve braktisës të shkollimit të obliguar -16 nxënës braktisës dhe 3 të rikthyer (27 Maj 2024)**
- **Shpërndarja e vërtetimeve të mësimdhënësve të pensionuar, kontributdhënës të viteve 90/99, procedura në vazhdimësi.**
- **Përzgjedhja nga DKA i Ekipit të III-të Për Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave**

nga Kolegët ,në Shfmu"28 Nëntori" në Raushiq, data e vlerësimit 27.05.2024 deri 31.05.2024.

- Organizim i takimit " Shendeti riprodhues gjithperfshires" - pjesë e kurrikules se re lëndore
- Pjesëmarrja e zyryareve të DKA-së dhe mësueses së shkollës SHFMU" Lidhja e Prizrenit" Adelina Laja, në Manifestimin 'Festa e Abetares "në nivel kombëtar në Gjilanë maj 2024
- Organizimi nga DKA, në përkrahje të zyrës së kryetarit, e punëtorisë në Durrës dhe vizitës studimore në qytetin e Elbasanit, me drejtor ,zv,drejtor shkollave,zyrtar të DKA-së,zyrtar komunal 23-24-25 maj 2024
- Bashkëpunimi me OJQ të ndryshme në interes të arsimit në shkollat e komunës së Pejës- në vazhdimësi(Human,Save the children , Syriivizionit , YENI-Caritasi Zviceran , etj)
- Organizimi i vizitave mjekësore të nxënësve të katër shkollave pilot (ShFMU"Asdreni" ShFMU" Lidhja e Prizrenit " ShFMU"Xhemajl Kada" dhe ShFMU"7 Shtatori" kl II-të VI-të dhe IX-të) -projekt i Drejtorisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me DKA
- Organizimi i testit Timss 2024 në formë elektronike në qendren e testimit IAAP" Rifat Gjota"- me nxënës të klasave të IV-ta të 7 shkollave të Komunës së Pejës-nga data 03-07.06.2024
- Vlerësime pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga ana e Ekipit Vlerësues Komunal. Janë vlerësuar 41 raste - dt.janar -qershor 2024
- Regjistrimi i nxënësve në klasë parafillore dhe në klasë të para për vitin shkollor 2024/2025 -datë 15.05.2024-vazhdon
- Takim informues me mësimdhënës të caktuar në administrim të testit të Maturës 2024 dhe testit të Arritshmërisë -qershor
- Caktimi i Qendrave të testimit (shkolla) për sistemimin e maturantëve ku do t'i nënshtrohen testit të Maturës 2024 (forma e aplikimit on-line në e-Kosova)
- Organizimi i testit kombëtar Matura 2024-me dt.22.06.2024.
- Organizimi i Testit të Arritshmërisë 2024 me 25.06.2024 dhe 28.06.2024 - 1358 nxënës do ti nënshtrohen testit i cili do të mbahet në 10 qendra të testimit
- **Administrata**
- Përgjigje në kërkesa dhe ankesa të palëve , bazuar në ligj dhe vendosja në programin

INTRANET

- Pranimi i Aplikacioneve në konkurset e shpallura
- Zbatimi i detyrave administrative si : vendimet e ndryshme ligjore për mësimdhënës dhe palë të tjera, kontratat e punës, vendimet për nderprerje të mardhënies së punës, pa pagese ,pushimet e lehonise etj
- Pelqime ,Rekomandime ,njotime për shkolla
- Ankesa ndaj vendimeve te inspektoriatit
- Pjesëmarrja në vendime të komisioneve disiplinore, te ankesave etj.
- Vizita të rregullta në institucionet arsimore me qëllim të monitorimit të gjendjes në shkolla.

Spektori I Financave

TRANSPORTI I NXËNËSVE NË RELACIONET MBI 4 KM dhe fëmijëve me nevoja të veçanta - sipas ligjit për AP, neni 15 dhe neni 40.

PËRCJELLJA E NDRYSHIMEVE NË LISTËN E PAGAVE Janar-qershor 2024

Zotimet e mjeteve buxhetore - Janar –Qershor - 2024

Zotimi i mjeteve dhe regjistrimi ne forme kompjuterike

Percjellja e mjeteve te alokuara dhe mjeteve te shpenzuara

Nxerrja e raporteve nga sistemi I Freebalancit dhe kontrollimi I ecurise se pagesave permes sistemit te Freebalancit

Pregaditja e pagave, tatimeve e kontributeve per mesuese mbeshtetese dhe percjellja per pagesë.

Pregaditja e specifikacioneve per komunal, percjellja per pagese, dhe dergimi I emajleve te kompanit perkatese si dhe krahasimi me pasqyrat e pagesave nga kontraktoret.

Futja e te dhënave per komunal ne databazen e instaluar nga zyra e IT-se se Komunes.



**RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËVE TË
KRYERA DHE AKTIVITETEVE NGA
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE
HIDROEKONOMISË**

QERSHOR, 2024

Përmbajtja:

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

- 1.1. Tabela e kërkesave të ndara sipas numrit dhe statusit
- 1.2. Tabela e kërkesave sipas kategorive
 - 1.2.1. Inkasimet e të hyrave nga kontratat e marrjes me qira të tokave bujqësore komunale
 - 1.2.2. Inkasimet e të hyrave nga vendimet për ndërrim të destinacionit të tokës
- 1.3. Rritja në përqindje e kërkesave të parashtruara në DBPH për vitin 2024
- 1.4. Kërkesat e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe vërshimet
- 1.5. Kërkesat për vendosjen e paneleve solare

2.SUBVENCIONET NGA DREJTORIA E BUJQËSISË

- 2.1 Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor

3.BASHKËPUNIMET ME DONATORË

- 3.1 Bashkëpunimi me Organizatën Syri Vizion
 - 3.1.1 Tabela me sektorë përfitues të grantit nga Syri Vizion
- 3.2 Bashkëpunimi me Organizatën “Caritas”
- 3.3 Marrëveshja e bashkëpunimit me “Islamic Relief Kosova”

4.AKTIVITET E DREJTORISË PËR BUJQËSI

- 4.1 Monitorimi i Vendgjuetive
- 4.2 Workshop-i i Organizatës CARE
- 4.3 Lansimi i programit “EREA”
- 4.4 Seminari i mbajtur nga Kooperativa COOPEX me perfaqësues francez
- 4.5 Tryezë e rumbullakët me përfituesit e projektit WEERA
- 4.6 Nënshkrimi i kontratave të përfituesve të granteve nga OJQ Syri Vizion
- 4.7 Inagurimi i serave moderne në fshatin Leshan
- 4.8 Mbajtja e sesionit informues me Caritasin Zvicëran
- 4.9 Fillimi i procedurave të ritenderimit për projektin “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores”
- 4.10 Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë

5.INVESTIMET KAPITALE

- 5.1 Planifikimi i inv.kapitale (kanaleve të ujitjes) për vitin 2024-2025
- 5.2 Vazhdimi i projekteve të mbetura nga viti i kaluar (situacionet përfundimtare)

6.SUBVENCIONET E MBPZHR

- 6.1 Afati i aplikimit për TM2 i vitit 2023
- 6.2 Afati i aplikimit në Programin e Pagesave Direkte për sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore të përcaktuara në PPD 2024

7.AKTIVITETET E QENDRËS INFORMUESE KËSHILLIMORE (QIK)

8.SEKTORI I PYLLTARISË

Puna vjetore në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi përfshinë koordinimin e zhvillimeve në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë. Kemi punuar në përmirësimin e rendimentit (produktivitetit) në kulturat kyçe, rritjen e përdorimit të teknologjisë moderne në bujqësi si dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore (kanale, penda).

Gjatë këtij viti kemi implementuar projekte inovative, si trajnime për fermerët dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme.

Për sfidat e hasura, kemi zhvilluar strategji për të adresuar çështje (problematika) të ndryshme në të mirë të fermerëve në territorin e Komunës së Pejës.

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

Gjatë gjashtëmujorit të I-rë kemi pranuar gjithsej **802** kërkesa. Këto kërkesa janë të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Shqyrtimi i tyre është bërë nga zyrtarët e DBPH-së dhe janë përfunduar mbrenda afateve të caktuara kohore, me përjashtim të një numri kërkesash të cilat janë ende në shqyrtim për shkak se jemi ende në fazën e përzgjedhjes së grupit të dytë të përfituesve të projektit për furnizim me mekanizma bujqësor.

1.1 Në tabelën e posht-shënuar janë të paraqitura kërkesat e ndara sipas llojit, numrit dhe statusit:

	Të pranuar	Në proces	Të miratuara	Të refuzuara	Hedhur poshtë	Të pezulluara	Të anuluar
	802	615	181	3	0	0	3

1.2 Kërkesat sipas kategorive:


Kërkesa për marrje me qira të tokës komunale	Kërkesa për ndërrim të destinacionit të tokës	Kërkesa për vërtetim që është i regjistruar si fermer/për aplikim vizë	Kërkesa për dëme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore	Kërkesa për marrje të pëlqimit për separacione	Vërtetim që dëshmojnë se kompanitë nuk kanë obligime ndaj DBPH-së
2	3	1	4	1	3

- **1.2.1 Kërkesa për marrje me qira të tokës bujqësore komunale:** 2 aplikues si persona fizik. Persona juridik nuk ka pas aplikues.
 . -Këto kërkesa për marrje me qera të tokës komunale nuk janë miratuar pasi që për vitin 2024 kjo taksë nuk është paraparë me Rregulloren Komunale për Taksa dhe Tarifa.
 Kjo taksë do të jetë pjesë e Rregullores për vitin 2025.
- **1.2.2 Ndërrimi i destinacionit të tokës:** 1 aplikues si person juridik dhe 2 aplikues si persona fizik.
Totali i të hyrave – 1,122.75 €.

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave në sistem kanë qenë edhe aplikuesit të cilët kanë aplikuar në Thirrjet Publike të shpallura nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Janë punuar shkresa të ndryshme për Ministrinë e Bujqësisë, rekomandime për Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën e Prokurimit, Vendime, Procesverbale të vlerësimit të dëmeve etj.

1.3 Nëse bazohemi në raportin e gjashtëmujorit të parë të Drejtorisë së Bujqësisë për vitin 2023, shohim se këtë vit ka pasur dukshëm rritje të kërkesave, nga **516** në **802**.



1.4 Nga Komisioni Komunal i Vlerësimit të Dëmeve janë pranuar dhe janë në shqyrtim 5 kërkesa të dëmeve të shkaktuara nga fatkqesitë e ndryshme natyrore, si dhe dëme të shkaktuara ne sektorin e blegtorisë nga sëmundje të ndryshme.

1.5 Kemi pranuar dy (2) kërkesa për ndrrim të përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, për vendosjen e **paneleve solare**.

1. Kompania “DUKAGJINI SOLAR SVERKE 04 L.L.C” – Me pëlqim të DUMM bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale Nr.65/2023, dhe Aktvendim të DBPH lejohet ndrrimi i përkohshëm i destinimit të tokës për ndërtimin e parkut solar në sipërfaqe të mëdha, në ngastrat e cekura në kërkesë. Sipërfaqja që do të ndërrohet është 105ha e 6572 m² dhe duhet të paguhet shuma prej 158,485.80 Euro, sipas UA nr.41/2026 neni 14, pika 14.2 paragrafi b) për kompenzim.
2. Kompania “SOLARISS L.L.C” – Me pëlqim të DUMM bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale Nr.65/2023, dhe Aktvendim të DBPH lejohet ndrrimi i përkohshëm i destinimit të tokës për vendosjen e paneleve solare në fshatin Kosuriq, sipas ngastrave të cekura në kërkesë. Sipërfaqja që do të ndërrohet është 106.8473ha dhe do të paguhet shuma prej 160,270.95 Euro, sipas UA nr.41/2006, neni 14, pika 14.2, paragrafi b) për kompenzim.

Të gjitha këto pagesa do të kryhen në Fondin Komunal.

2. SUBVENCIONET E D.B.P.H

2.1 Sipas thirrjes publike të dt.08.04.2024, më nr.prot.12/320-01/27801, planifikimit buxhetor dhe vendimit të Zyrës së Kryetarit më nr.400-01/41901/2024 të dt.27.05.2024 është shpallur afati i aplikimit për përkrahjen financiare (subvencionimin) të projektit **“Përkrahja e fermerëve-bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim.**

Ky projekt ka qenë bashkëpunim në mes të Komunës së Pejës dhe fermerëve, ku Komuna ka participuar me 70% kurse fermerët 30 % të vlerës financiare.

Vlera totale e projektit ka qenë **89,980.00 €**.

Për këtë projekt kanë aplikuar **537** fermerë, përfitues janë shpallur **106** prej tyre.


Mekanizmat e shpërndarë janë:

1. 40 Freza 1.8m
2. 20 Freza 2.0m
3. 20 Spërkatëse
4. 20 Shpërndarëse të plehut 350L me kardan
5. 6 Makina mbjellëse të misrit 4 rendëshe pneumatike

Gjatë muajit qershor pritet që nga lista e pritjes nga aplikacionet e mbetura të shpallet edhe grupi i dytë përfitues i projektit të lartpërmendur.

Do të shpërndahen gjithsej 49 freza dhe 16 spërkatëse, në vlerë financiare 48,080.00 Euro.

3. BASHKËPUNIMET E D.B.P.H ME DONATORË




3.1 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, si dhe përfaqësues nga OJQ “SYRI VIZION”, kanë nënshkruar marrëveshjen e partneritetit për implementimin e projektit “Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë”.

Qëllimi i memorandumit është që përmes DBPH që ka shprehur dëshirën për participim në vlerë prej 15.000.00 euro në këtë projekt, të krijoj mundësi të reja për përfituesit e përzgjedhur të këtij projekti.


3.1.1 Nga ky projekt përfituan gjithsejt 15 biznese familjare (gra fermere), ku në tabelën e paraqitur më poshtë i kemi paraqitur shumat e fituara të grantit si dhe sektorin ku kanë përfituar:

SEKTORI	SHUMA E PËRFITUAR E GRANTIT
Mekanizim - Perimtari, agro-turizëm-kultivator, freze, pllug	5,500.00 €
Mekanizim -mbjellëse pneumatike - lavërtari, blegtori	5,500.00 €
Perimekulturë, serre, kultivator, freze, pllug	5,330.00 €
Makina për përpunimin e frutave organike në lëngje dhe raki hydroprese pasterizator, mulli për bluarje	4,950.00 €
Përpunimi i mollës së egër- prodhimi I uthullës nga molla e egër	5,500.00 €
Perimekulturë, serre, kultivator	5,500.00 €
Mekanizim -freze, mikser për bluarjen e ushqimit- lavërtari, blegëtori	5,500.00 €
Bletari-centrifuge, shkrirëse e dyllit, depozit, koshere me blete	5,470.00 €
Mekanizim -freze, pllug, spërkatëse, lavërtari, blegëtori	5,240.00 €
Mekanizim - BMA -moto kultivator, freze, pllug, kose	5,500.00 €
Mekanizim -moto kultivator, kose, freze, pllug- Perimtari	5,500.00 €
Bletari-koshere, centrifug, pajisje tjera të bletarisë	5,243.00 €
Mekanizim - lavërtari, blegëtori- grabuje, kose, ngarkues plehu, mbjellëse e grurit	4,400.00 €
Kultivuese e arrës, pemëtari, kose fidanë arre, pajisje	5,220.00 €
Perimekulturë, serre, sistem i ujitjes, pompa	3,500.00 €
TOTALI:	77852.5 €

3.2 Komuna e Pejës në bashkëpunim me Caritasin Zviceran ka subvencionuar fermerët kultivues të pemëve të imëta (mjedër dhe boronicë). Tek kultivuesit e boronicave kanë përfituar grant 7 fermerë, në sipërfaqe prej 2.5ha në vlerë 70,000.00euro, kurse tek kultivuesit e mjedrës kanë përfituar 11 fermer në sipërfaqe 1.60ha në vlerë 36,000.00 euro. Komuna ka participuar me 8,000.00 euro për blerjen e foljeve.



3.3 Në parim kemi arritur marrëveshje për vazhdimin e bashkëpunimit me organizatën “Islamic Relief Kosova”,ku si synim kemi furnizimin e fermerëve me sera 1 dhe 5 ari dhe mekanizma bujqësorë (makina mbjellëse të misrit, freza të madhësive të ndryshme, spërkatëse). Vlera e projektit pritet të arrij vlerën 300,000.00 Euro dhe do përfitojn rreth 240 fermerë.



4. AKTIVITET E D.B.P.H-së

- 4.1** Monitorim i vazhdueshëm i Vendjguetive. Shoqata e Gjuetarëve “Reqebulli” në periudhën dimërore ka ndihmuar kafshët e egra malore duke u përkujdesur për ushqyeshmërinë e tyre.
- 4.2** Gjatë muajit janar është mbajtur Workshop i Organizatës CARE me gratë përfituese të projekteve për bizneset e tyre familjare.
- 4.3** Në muajin shkurt kemi marr pjesë në lansimin e programit “Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi” EREA,program ky i cili synon të jap energji të re,inovacion,zgjidhje dhe përparim të mëtejshëm për ekonomitë rurale dhe fermerët e përkushtuar të Kosovës. Programi EREA financohet nga Caritasi Zviceran.
- 4.4** DBPH ka mbajtur seminar për blegtorë me ekspert francez nga Kooperativa Bujësore COOPEX dhe nga Instituti i Blegtorisë i Republikës së Francës si dhe përfaqësues nga MBPZHR. Seminari është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal Pejë me dt.28.03.2024 dhe është diskutuar rreth selektimit gjenetik të kafshëve si dhe rëndësia e përgaditjes së ushqimeve në bazë të proteinave.
- 4.5** Është mbajtur tryezë e rrumbullakët me gratë fermere përfituese të projektit WEERA ,për integrimin e perspektivës gjinore në politikat komunale.
- 4.6** Me dt.03 prill është bërë nënshkrimi i kontratave me përfituesit e projektit nga OJQ “Syri Vizion”.Kanë qenë gjithsejt 28 përfitues fermerë nga katër komunat: Pejë,Istog,Gjakovë dhe Rahovec. Vlera totale e projektit për Komunën e Pejës ka qenë 77,852.50 Euro.
- 4.7** Kemi marr pjesë në inagurimin e serave moderne në Regjionin e Pejës,më saktësisht në fshatin Leshan.Duke i`u faleminderuar mbështetjes zvicerane,shtatë sera moderne do të ndërtohen në regjione të ndryshme të Kosovës.Kjo do të kontribuojë në ngritjen e produktivitetit në gjithë sektorin e Agrokulturës,duke përfituar kështu një numër i madh i fermerëve.
- 4.8** Me dt.26 prill është mbajtur sesion informues nga DBPH në bashkëpunim me CARITAS-in Zviceran në lidhje me fuqizimin e iniciative të grave në sektorin e bujqësisë.
- 4.9** Përgaditja e paramasave dhe parallogarive për shpalljen e RITENDERIT nga Zyra e Prokurimit për projektin “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”.
- 4.10** Në periudhën 27.05-31.05.2024 është bërë shpërndarja e mekanizmit bujqësor sipas listave përfituese.

FOTO NGA DISA PREJ AKTIVITETEVE TË LARTËCEKURA:



1.Ushqyeshmëria e kafshëve të egra gjatë periudhës dimërore



2.Pjesëmarrja në lansimin e programit “Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi” EREA



3.Nënshkrimi i marrëveshjes së partneritetit në mes Komunës së Pejës dhe OJQ “Syri Vizion”



4. Seminar për blegtorë me ekspert francez nga Kooperativa Bujësore COOPEX dhe nga Instituti i Blegtorisë i Republikës së Francës



5. Sesion informues nga DBPH në bashkëpunim me CARITAS-in Zvicëran në lidhje me fuqizimin e iniciative të grave në sektorin e bujqësisë.



6. Nënshkrimi i kontratave me përfituesit e projektit nga OJQ “Syri i Vizionit”.




7. Tryezë e rrumbullakët me gratë fermerë përfituese të projektit WEERA



8.Kultivuesit e mjedrës,përfitues të projektit nga Caritas-i Zviceran



9.Kultivuesit e boronicave,përfitues të projektit nga Caritas-i Zviceran



10.Inagurimi i serës moderne nga përkrahja zvicerane në Komunën e Pejës



11.Punimet drejt përfundimit në ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Qenëve Endacak



12.Plani i Ambulantes Veterinare për Trajtimin e Qenëve Endacak



13. Shpërndarja e makinerive bujqësore për fermerë

5. INVESTIMET KAPITALE

5.1 Jemi në fazën e përpilimit të paramasave dhe parallogarive sipas kërkesave të fermerëve, kërkesave të kryetarëve të bashkësive lokale si dhe dëgjimeve buxhetore për vitin 2024-2025 projekte këto të cilat si investime kapitale pritet të procedohen gjatë muajit qershor tek Zyra e Prokurimit.

Kanalet e planifikuara janë në këto fshatra: Vragoc, Pavlan, Qyshk, Gllaviqicë, Ramun, Trestenik, Nabërgjan, Loxhë, Çallapek, Baran, Raushiq, Dobërdol, Kosuriq, Broliq, Graboc, Llabjan, Ruhot, Nakëll, Ozdrim, Dubovë, Leshan, Kliqinë, Nepole si dhe në fshatrat e Podgurit.

Sipas raporteve të mbikëqyrësve të kontratave për kanale, dhe pagesave të realizuara nga DBPH janë përfunduar pothuajse të gjitha punët nga viti i kaluar, me përjashtim të një numri të vogël projektesh që pritet të vazhdojnë situacionet e fundit dhe përfundojnë në vitin kalendarik 2024.

5.2 NË TABELËN MË POSHTË JANË TË PARAQITURA PROJEKTET E MBETURA NGA VITI 2023 QË JANË NË PËRFUNDIM E SIPËR :


Nr.	Projekti	Shuma e kontratës	Të paguara	Përfunduar/ Në proces	Sqarime shtesë
1.	Ndërtimi I kanalit të ujitjes në fsh.Loxhë	€ 59,675.00	€ 22,777.52	Në proces	38% e punëve të kryera
2.	"Ndërtimi I kanalit të ujitjes në fsh. Lutogllavë,Nabërgjan,Tre stenik dhe Vitomiricë"	€ 167,863.00	€ 96,049.98	Në proces	58% e punëve të kryera
3.	"Ndërtimi I kanalit të ujitjes në fsh. Treboviq dhe Kryshec"	€ 21,902.00	€10,405.00	Në proces	50% e punëve të kryera
4.	"Ndërtimi I kanali të ujitjes në fsh.Baran (Jazi I Mullirit)	€ 69,760.60	€ 49,500.00	Në proces	70% e punëve të kryera
5.	"Ndërtimi I kanalit të ujitjes në fsh. Bllagajë,Nakëll dhe Zahaq"	€ 82,563.00	€ 62,910.00	Në proces	76% e punëve të kryera

5.3 Për gjashtëmujorin e I-rë të vitit 2024 janë kryer këto pagesa nga investimet kapitale në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë:

Investime kapitale – 153,719.96 Euro (Të planifikuara 527,500.00 €) – Realizimi 30 % i buxhetit
Subvencione – 93,522.68 Euro (Të planifikuara 200,000.00 €)- Realizimi 53 % i buxhetit

6. SUBVENCIONET E MBPZHR-së (PROGRAMI I PAGESAVE DIREKTE)

6.1 Nga dt.**15.01-13.02.2024**, MBPZHR-ja ka shpallur thirrje për aplikim për TM2(subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë) për vitin 2023.




6.2 Programi për Pagesa Direkte për vitin 2024, nga MBPZHR është shpallur nga dt.13.03.2024 deri me 12.04.2024.

Kanë aplikuar gjithsej **1813** fermerë nga Komuna e Pejës, që kanë aplikuar me kultura të ndryshme bujqësore të mbjellura, të cilat subvencionohen direkt nga Ministria e Bujqësisë.

Për dallim nga viti i kaluar kemi rritje në sipërfaqe **1,267.2ha**, konkretisht tek misri,si dhe këtë vit ka rritje të dukshme në sipërfaqet e mbjellura me perime.

Nga grafikon shihet që ka një rritje prej afër 10% nga viti paraprak të sipërfaqeve të mbjellura me kultura bujqësore.



7. AKTIVITETET E QENDRËS INFORMUESE DHE KËSHILLIMORE

Nga data 24.02-15.03.2024 në Qendren e Trajnimit në Lipjan është mbajtur trajnim me këshilltarët publik dhe privat lidhur me avancimin e shërimeve këshillimore në nivel vendi.

Janë njoftuar fermerët pronar të bujtinave për mundësinë e aplikimit në Grante.

Është mbajtur takim me kultivuesit e trangullit dhe kompaninë AgroCelina në Rahovec me qëllim të grumbullimit të këtij produkti për eksport jashtë vendit.

Janë kryer vizita në terren tek disa fermerë me rastin e paraqitjes së dëmtuesit në kulturën e grurit (morri).

Janë dërguar raporte mujore në DSHKT-Prishtinë.

Janë ndihmuar rreth 76 fermerë për aplikim në grantet e AZHB-së, me këshilla për kompletim të dokumentacionit, sqarime lidhur me procedurat e aplikimit si dhe forma të tjera në mënyrë që fermerët të jenë aplikues dhe përfitues.

Organizimi i këshillimeve me fermerë me dt.07.06.2024 në Qendrën e Trajnimeve në fshatin Novosellë me temën "Kultivimi i pemëve të imëta-Mjedër".

Me dt.19.06.2024 këshillime me fermerë në Qendrën e Trajnimit në Novosellë me temën "Kujdesi ndaj bletës gjatë muajve të verës", me ligjëruesit Elbasan Qekaj dhe Venera Kelmendi.

8.KËRKESAT DHE AKTIVITETET E SEKTORIT TË PYLLTARISË

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Pejës të dt.05.12.2023 me nr.protokoli 5066,është bërë transferimi nga komuna në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të pylltarisë,rojeve të pyllit,teknikëve të pylltarisë ,përgjegjësive të njësive komunale etj,bashkë me mjetet buxhetore përkatëse,automjetet dhe paisjet tjera si dhe mjetet përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Përgjegjësi e njësisë komunale është mbikëqyrja e dy Vendgjuetive në Komunën e Pejës (Duboçaku dhe Podguri).



KOMUNA E PEJËS

RAPORTI JANAR-QERSHOR 2024

DREJTORIA

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Diellëza Berisha

EMRI I DREJTORIT TË FINANCAVE:

GAZMEND MUHAXHERI

EMRI I KRYETARIT TË KOMUNËS:

Fusha	Aktiviteti	Rezulltati
FINANCA	Përmbyllja e vitit paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Analizë e të hyrave të vitit paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditjet me Informata financiare, komunikim me Drejtoritë tjera për të arketueshmët.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditja, dhe bartja e mjeteve te vitit paraprak.	E përfunduar, Maj 2024
	Analize Financiare për tremujorin e parë të vitit.	E përfunduar, Prill 2024
	Procesi I Auditimit të jashtëm.	E përfunduar, Mars 2024
	Pergaditja e Kabit Komunal	E përfunduar, Qershor 2024 ne Kuvend
	Pergaditja e transferit permes Asamblese Komunale	E papërfunduar, (e derguar ne Maj 2024, ne proces)
	Kerkesat ne thesar per perditesim te shpenzimit te parase	Gjatë gjithë deri me tani 2024
	Pergaditje dhe publikim I raporteve mujore	Çdo muaj
	Zotim I mjeteve sipas kërkesave.	Gjatë gjithë 6 Mujorit
	Procesim I Pagesave per te gjitha kategorite ekonomike	Gjatë gjithë 6 Mujorit
	Analize Financiare për projektet kapitale.	Gjatë gjithë 6 Mujorit
	Pergaditje e zotimeve sipas planit te prokurimit	Gjatë gjithë 6 Mujorit
	Alokim I të hyrave.	Gjatë gjithë 6 Mujorit

Fusha	Aktiviteti	Rezulltati
BUXHETI	Përgaditje e Raportit të të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin Paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditje dhe Finalizim i Pasqyrave Financiare.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditje e Raportit të të Hyrave dhe Shpenzimeve për tremujorin e parë.	E përfunduar, Prill 2024
	Përgaditja e Kabit Komunal	E përfunduar, Qershor 2024 ne Kuvend
	Mbajtja e degjimit publik per KAB	E përfunduar, Qershor 2024
	Protokolim dhe barazim I faturave me Departamentin e Financave	Gjatë gjithë 6 Mujorit
Fusha	Aktiviteti	Rezulltati
Tatimi në Pronë	Analizë e të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Shpërndarje e Fakturave të Tatimit në Pronë	E përfunduar, Mars 2024
	Pranimi I Ankesave për Tatimin në Pronë.	Gjatë gjithë vitit 2024
	Regjistrim I Objekteve te reja.	Gjatë gjithë 6 mujorit
	Lëshim I vertetimeve, printim I fakturave, pagese e takses rrugore	Gjatë gjithë 6 mujorit
	Rianketim I Objekteve.	Gjatë gjithë 6 mujorit



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike

Datë 14.06.2024

Raporti i punëve të Drejtorisë për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2024

- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike nga Janari deri me tani ka pranuar gjithsej **272** kërkesa nga palët, nga të cilat të miratuara janë **225**, të refuzuara **2** kërkesa, ndërsa të pezulluara dhe lëndë në proces si dhe raste të cilat janë hapur ex- officio janë **45** raste - të natyrës Këmbim prone dhe Ankesa për uzurpim të pronës;
- Në **6** mujorin e parë të këtij viti jemi marrë me lëndët të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme duke përfshirë lëndët për shpronetime, këmbime, dhëniës së lejës për shfrytëzim të përkohshëm të pronës publike, evidentimin dhe parandalimin e uzurpimit, si dhe largimin e uzurpimeve nga pronat komunale;
- Në lagjet “Kapeshnica” dhe “Puhovci” janë rrënuar **6** shtëpi dhe **2** lokale të cilat nuk ishin të pajisura me leje apo nuk ishin në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal. Ndërsa, edhe **2** (dy) shtëpi janë në procedurë për rrënim në lagjen “Kapeshnica”;
- Në lagjen “Asllan Qeshme” është vazhduar me largimin e uzurpimeve mbi Kanalin e Ujërave Atmosferikë;
- Në procedurë për rrënim janë edhe **4** (katër) lokale në Qendrën e qytetit në “Korzo”, me ç’rast njoftimet i’u janë dërguar pronarëve (rrënimet do të fillojnë së zbatuari nga data 20 gusht 2024).

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer poashtu edhe:

- Kontrollin dhe hapjen e rasteve për shfrytëzim të pronës publike;

- Kontrollat dhe zhvillimin e procedurave për kioska dhe objekte të përkohshme të cilat janë në shfrytëzim nga palët.
- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike për uzupimet e pronës komunale ka lëshuar **2** (dy) gjopa: një në vlerë prej 1.000.00 €, ndërsa tjetër në vlerë 500.00 €, por të cilat ende nuk janë bërë të plotëfuqishme (pasi që palët kanë edhe 7 ditë kohë në dispozicion për shfrytëzimin e të drejtës së ankesës si mjet i rregullt juridik);
- Nga pagesat e panove reklamuese kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **86,838.25 €**.
- Nga pagesa e qirasë nga objektet publike të cilat janë në shfrytëzim- kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **3,097.50 €**.
- Nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike (Parkingje, Kioska, Tavolina) Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **58,972.60 €**.
- Nga këmbimet, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **27,204.00 €**.
- Nga data 01.01.2024 deri më 14.06.2024, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **176,112.35 Euro**.

**Udhëheqës i Sektorit për Çështje
Pronësore-Juridike**

Luan Gashi



DREJTORIA PËR ÇËSHTJE PRONËSORO - JURIDIKE

Në tabelen e mëposhtme është prezentuar realizimi i të hyrave vetanake sipas muajve , për gjashhtë-mujorin e parë të vitit 2024

REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE NËPËR MUAJ PËR GJASHTË-MUJORIN E PARË TË VITIT 2024

Kodi	Emërtimi i kodit	Janar	Shkurt	Mars	Priill	Maj	Qershor	Gjithsei
50212	Licenca për reklama dhe publikime në prona publike	450.00	22,012.35	18,584.60	8,610.60	21,427.50	15,753.20	86,838.25
50405	Shtytëzimi i pronës publike		290.00	240.00	58,122.60	320.00		58,972.60
50408	Qiraja nga objektet publike	680.00	185.50	370.00	1,239.00	319.00	304.00	3,097.50
50413	Të hyrat nga këmbimi i Pronës së Paluajtshme	40.00		24,564.00	2,600.00			27,204.00
	Gjithsei :	1,170.00	22,487.85	43,758.60	70,572.20	22,066.50	16,057.20	176,112.35

Udhëheqës për Qeshtë Pronësorë

Luan Gashi



[Handwritten signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Pejës
Opština Peć
Peja Municipality

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër /Direkcija za Geodezija i Kataster
/Department of Geodesis and Cadastre

PËR/ZA/TO:	z.Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Mustafë Nila, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM:	z.Argjent Lleshi,Shef i Sherbimit Juridik-Administrativ
LËNDA:	Raporti i punës për periudhën 03.01.2024. - 12.06.2024.
Data:/Datum:/Date:	13.06.2024.

Nr.	EMËRTIMI I LËNDËS	Numri i lëndëve
1	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TERREN	32
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	32
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	0
2	NUMRI I LËNDËVE NGA GJEODETAT PRIVAT	402
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	378
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	24
3	NUMRI I LËNDËVE PËR BARTJE TË PRONËS	1382
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	1240
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	142
4	NUMRI I LËNDËVE PËR HISTORIAT TË PRONËS	55
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	55
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	0
5	NUMRI I LËNDËVE PËR REGJISTRIM/FSHIRJE TË HIPOTEKAVE	220
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	196
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	24
6	NUMRI I LËNDËVE PËR LEGALIZIM	53
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	43
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	10

8	NUMRI I KËRKESAVE PËR FLETA POSEDUESE DHE KOPJE TË PLANIT	5449
7	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	10
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	70
	NUMRI I LËNDËVE PËR KORRIGJIM TË DHËNAVE	80

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024 I SEKTORIT TË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI 6 MUJOR I PUNËS ME AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË REALIZUARA - 2024 Biblioteka "Azem Shkreli"

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
11	Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës		€ 80,000.00	€ 80,000.00	SEFERI MONT
			1,017,389.73	735,531.41	



REGJISTRIMI I VIZITAVE NE SHTEPI PER GRA SHTATZENA DHE FEMIJE 0-3 VJEÇ 2024

Komuna e Pejës	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1 Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	45	63	61	43	55	65							332
2 Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	0	0	0	0	0	0							0
3 Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	45	63	61	43	55	65	0	0	0	0	0	0	332
4 Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	25	30	30	20	25	30							160
5 Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	20	33	31	23	30	35							172
6 Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	45	63	61	43	55	65	0	0	0	0	0	0	332
7 Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	0	0	1	2	0	0							3
8 Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç	0	0	0	0	0	0							0
9 Numri i vizitave të ketërta për fëmijët 0-3 vjeç	0	0	0	0	0	0							0
10 Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç	0	0	0	0	0	0							0
11 Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtënëake brenda 3 ditëve të para	0	0	0	0	0	0							0
12 Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	0	0	0	0	0	0							0
13 Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	0	0	0	0	0	0							0
14 Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0	0	0	0	0	0							0
15 Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0	0	0	0	0	0							0
16 Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	0	0	0	0	0	0							0
17 Numri i vizitave shtesë për fëmijë dhe shtatzëna (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	0	0	0	0	0	0							0
18 Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	0	0	0	0	0	0							0
19 Numri i rasteve sociale të identifikuara dhe të referuar	0	0	0	0	0	0							0
20 Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	0	0	0	0	0	0							0
21 Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)	0	0	0	0	0	0							0
22 Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	14	14	14	14	14	14							14

Komuna e Pejës	Lindjet e gjalla	Targeti Minima	Targeti Maksima	Vizitat e arritura deri më tani
	1037	3111	5185	332

Të dhënat që duhet të mblidhen: Numri i vizitave në Këshillimore														QKMF Peje
Periudha e raportimit: Janar - Dhjetor 2024														
Nr. i vizitave në Këshillimore														
Grupmosha	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar-Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj													0
	Femra													0
10-14	Meshkuj													0
	Femra													0
15-19	Meshkuj													0
	Femra													0
20-24	Meshkuj	1												1
	Femra													0
25-29	Meshkuj			1	1	1								3
	Femra			1	1	2								4
30-34	Meshkuj	2												2
	Femra	1												1
35-39	Meshkuj		1				2							3
	Femra	1		1	3									5
40-44	Meshkuj		3			1	1							5
	Femra	1		1	1									3
45-49	Meshkuj	2	1	2	1	5	1							12
	Femra	5		2	1	1								9
50-54	Meshkuj	5	3	7	3	2	2							22
	Femra	7	8	5	5	10	1							36
55-59	Meshkuj	7	5	13	6	15	3							49
	Femra	13	9	10	10	9	7							58
60-64	Meshkuj	10	5	14	7	12	1							49
	Femra	9	12	13	16	11	4							65
65-69	Meshkuj	19	21	24	11	11	7							93
	Femra	5	2	7	5	10	11							40
70-74	Meshkuj	9	23	21	7	10	6							76
	Femra	13	5	9	11	8	8							54
75-79	Meshkuj	5	3	5	3	4	4							24
	Femra	2	1	3		6								12
80+	Meshkuj	2	2	12	12	3	4							35
	Femra			2	2	5								9
Gjithsej		119	104	153	106	126	62	0	0	0	0	0	0	670

Përqindja e Vaksinimit –6 Mujori 2024

	Mosha	Nr.vj.i fëmijëve të planifikuar	Nr. i fëmijëve të vaksinuar	Përqindja e Fëmijëve të vaksinuar
BCG	0-11muj	970	447	46.08 %
HBV 1- ne lindje	0-11muaj	970	447	46.08 %
HBV 2	0-11 muaj	970	439	45.26 %
HBV 3	0-11 muaj	970	247	25.46 %
Dtap-lpv- Hib 1	0-11 muaj	970	469	48.35 %
Dtap-lpv-Hib 2	0-11 muaj	970	398	41.03 %
Dtap-lpv-Hib 3	0-11 muaj	970	311	32.06 %
Rota 1	0-11 muaj	970	432	44.53 %
Rota 2	0-11 muaj	970	372	38.35 %
Pcv 1	0-11 muaj	970	515	53.09 %
Pcv 2	0-11 muaj	970	426	43.92 %
MMR 1	12-23 muaj	970	334	34.43 %
Pcv 3	12-23 muaj	970	315	32.47 %
Dtap-lpv-Hib 12-18	12-23 muaj	970	106	10.93 %
Bopv R2	6vjeç	1214	896	73.80 %
DT R2	6vjeç	1214	896	73.80 %
MMR R2	6 vjeç	1214	896	73.80 %
Bopv R3	12 vjeç	1289	863	66.95 %
Td R 3	12 vjeç	1289	863	66.95 %
HPV R3(Vajza)	12 vjeç	626	415	66.29 %
Td R4	17 vjeç	1156	891	77.07 %

**Formulari për Raportimin e Përfshirjes me Vaksinim
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.....Pejë.....**

Periudha ..6 Mujor ...2024.....Data e raportimit.....03.07.2024.....

Grup-mosha	Fëmijet e planifikuar për vit	Fëmijet e planifikuar për muaj
0-11 muaj (BCG, HepB, DTaP, IPV, Hib,PCV,Rota)	970	
Te bartur per doze 2 dhe 3 HepB, DTaP, IPV, Hib,PCV	307	
12- 23 muaj (MMR, PCV,DTaP, IPV,Hib)	970	
Te bartur per MMR, , DTaP, IPV, Hib,PCV	52	
24-59 muaj (Fëmijët e mbeturë)	IPV/bOPV, DTP,Hib,HepB	136
	IPV/bOPV,DPT,PCV	136
	MMR	136
Fëmijët e klasës së I-rë (DT,bOPV,MMR)	1214	
Te mbetur nga kl I-rë (DT,bOPV,MMR)	79	
Fëmijët e klasës së VI-të (dT,bOPV,HPV)	1289	
Te mbetur nga kl VI-të (dT,bOPV,HPV)	138	
Fëmijët e shkollës mesme (dT)	1156	

Vaksinat	0-11 muaj	Te bartur	12-23 muaj	Te bartur	24-59 muaj	Kl.I-rë	Të mbetur	Kl VI-të	Të mbetur	Kl XII-të	Mbi 59muaj	TOTALI
BCG në lindje	Peja447 K.t284											447 284
Hep.B 1 në lindje	Peja447 K.t284											447 284
HepB 2	341	98			3							442
HepB 3		245	2	33	7							287
DTaP-IPV-Hib 1	239	227	3		5							474
DTaP-IPV-Hib 2	111	282	5	1	1							400
DTaP-IPV-Hib 3		304	7		4							315
Rota 1	233	199										432
Rota 2	107	265										372
PCV 1	223	292										515
PVC 2	111	315	85	29	7							547
MMR 1			334	19	19							372
PCV 3												
DTaP-IPV-Hib (12-18 m)		9	91	15	4							119
PCV (12-23m)			270	45	24							339

Raporti i aktiviteteve të Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për infermieri Janar – Qershor 2024

- Vazhdimi i aktiviteteve në QTMF në ESP nga MF, ku tranjerët e QTMF kanë plotësuar angazhimet në kuadër të ESP në MF si dhe objektivat e zhvillimit të konceptit të MF.
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore si dhe matja e performancës së Institucioneve shëndetësore është realizuar përmes Komunitetit për Ngritje të Cilësisë së Shërbimeve
- Aktivitetet në Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional i kuadrove ekzistuese, mjek dhe infermier, i cili realizohet në bazë të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, dhe Odave të profesionistëve shëndetësor të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, mbështetur në arritjet bashkëkohore të Mjekësisë Familjare. Ky segment është ndikuar shumë Gjatë periudhes Janar-Qershor 2024 është realizuar rreth 60% prej planit si për mjek poashtu edhe për infermier.
- Vazhdimi i aktiviteteve në QTMF në SHSP nga MF, ku tranjerët e QTMF kanë plotësuar angazhimet në kuadër të SHSP në MF si dhe objektivat e zhvillimit të konceptit të MF.
- Aktivitetet në promovimin shëndetësorë dhe pjesëmarrje në komunitet përmes edukimit dhe shënimit të ditëve të shënuara si ditës së zemrës, tymosjes së duhanit AIDS, Kancerit të gjirit, përmes aktiviteteve në komunitet si dhe ngritjes së vëtedijes për parandalimin kundër këtyre patologjive.
- Realizimi i “Programt të Vizitave për Nëna dhe Fëmijë” në kuadër të programit
- MSh/UNICEF-it. Gajtë kesaj periudhe janë realizuar gjithësejt 373 vizita prej tyre 170 gra shtatëzna dhe 177 fëmijë.

- Vazhdimi i projektit për skreningun e Qafës së Mitrës, projekt i cili realizohet në partneritet me AMC, dhe Spitalin Regjional.
- Gjatë periudhes Janar- Qershor 2024 janë realizuar vizita në teren kryesisht për rastet me sëmundje kronike, pacientët e palëvizshëm dhe ata më sëmundje terminale, si dhe rasteve të hendikepuara dhe me nevoja të veçanta.

Qëllimi :

- Promovim sa më të mirë të Edukimit Shëndetsor
- Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në praktik
- Implementimin e nevojave të reja
- Menagjimi i informacioneve te reja
- Vazhdimi i edukimit shëndetësor në komunitet

Ecuria e ligjëratave:

Trajnimet fillimisht janë mbajtur katër herë në muaj, pjesmarrësit janë lajmëruar me kohë.

Në çdo prezantim është diskutuar në mënyrë interaktive për rolin dhe detyrat e mëtutjeshme

pas trajnimit konkretisht për implementimin e njohurive të reja në praktikën e përditshme

infermierore.

Deri me tani janë trajnuar gjashtë grupe të pjesëmarrësve 69 infermiere dhe profesioniste tjere shendetesore, kemi planifikuar edhe 10 grupe deri në fund të vitit 2024

Konkluzionet:

Mund të konkludoj që për sa i përket vijshmërisë së pjesëmarrësve vlen të theksohet se interesimi ka qenë shumë i lartë si nga ana e prezentuesve ashtu edhe nga ana e audiencës.

Dua të theksoj se pëkundër ngarkesës së shtuar në punë gjithmonë unë me stafin menaxhues dhe të gjithë infermierët kemi gjetur alternativa nga më të përshtatshmet në mënyrë që aktivitetet e ZHVP-së të realizohen pa lënë asgjë të përealizuar as nga obligimet praktike dhe as nga ato edukative dhe promovuese në punë.

Nr	Trajnim /punetori /session informues	Organizuar nga	Nr I pjesemarrësve
1.	Dixhitalizimine Raportimit te EPPV	IKSHP 15/01/2024 , deri më 18-01-2024	10
2.	Gripin sezonal & vaksinimin.	IKSHP 05-12 Shkurt 2024	10
3.	Pakon Minimale Fillestare e Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS) në gjithë Komunat e Republikës së Kosovës.	Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe në partneritet me UNFPA	1
4.	Projektit Age + është edhe “Kontrolla Bazike Shëndetësore dhe Këshillim”.	Syri I vizionit 25.03.2024	2
5.	Fuqizimi i pacientëve me diabet – mësim nga Sllovenia dhe hapat e mëtejshëm për Kosovën”.	IHS 21.03.2024	2
6.	"ETIKA PROFESIONALE DHE TE DREJATAT E PACIENTEVE	Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe në partneritet me UNFPA 22.03.2024	2
7.	Sistemi i Menaxhimit te Cilesise	AQH 20.04.2024	5
8.	Shënimin e Javës së Imunizimit	IKSHP 22.04.2024	3
9.	"Këshillim Motivues"	AQH 23-24.05.2024	2
10.	Njoftimin për fillimin e procesit te	Ministria e	2

	përzgjedhjes se mjekut familjar për terë territorin e Republikës së Kosovës	Shëndetësisë në bashkëpunim me AQH 29.05.2024	
11.	instalimi i data bazës për Këshillmore ,përkatësisht regjistrat për menaxhimin e SJN	AQH 30.05.2024	2
12.	"Menaxhimi gjithëpërfshires sindromik i rasteve te IST -ve	Aksioni per Nena dhe Femije me mbeshtetjen e Fondit per Popullesi i Kombeve te Bashkuara - UNFPA 3 - 5 qershor 2024	2
13.	TOT planin e veprimit për Vete-menaxhim te pacienteve me diabet dhe HTA,	IHC 10-14.06.2024	2
14.	"Këshillimin Motivues" ,	10 dhe 11 qershor 2024	2
15.	(ToT) për "Kujdesin ndaj personave të moshuar	IKSHP AQH 12,13,14.06.2024	2
16.	Komunikimi dhe mardhenjet nder-personale ne kujdesin shendetesor	IHC 19.06.2024	2
17.	"Roli i komunave në zbutjen e varfërisë menstruale",	EcoKosËomen 20.06.2024	1
18.	Antigjipsizmin në Kosovë	Terre des homese Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Zyren për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit 20.06.2024	10
19.	Projektit Age + është edhe "Kontrolla Bazike Shëndetësore dhe Këshillim".	Syri I visionit 21.06.2024 Novosell	1
20.	Karavanin shëndetësor,	Organizata Syri i Vizionit në bashkëpunim me AQH	4

Raport i shkurtër i procesit të trajnimit të infermiereve në kuadër të EVP në QTMF në Peje

Një raport i shkurtër për procesin e trajnimit të infermierëve në QKMF-QTMF/ 2024
Kemi filluar me 18.03.2024 trajnimin katër ditor ,Plani për EVP infermiere dhe profesionist të tjerë shëndetësor' në
QTMF në Peje

Akredituar nga Oda e Infermiereve të Kosovës
Përshkrimi i aktivitetit 05/1-UA21N si pjesë e EVP-së dhe vlerësohet me:

- 30 Pikë akredituese për pjesëmarrës aktiv
- 20 Pikë akredituese për pjesëmarrës pasiv

Pjesëmarrësit në këtë trajnim kanë fituar 20 pike akredituese dhe janë trajnuar në grupe

Preje Mars 2024 deri në Qershor 2024 në mënyrë që të përfundojnë trajnimin gjithë stafi i infermierisë dhe profesionistët tjerë shëndetësor në QKMF deri në Dhjetor

GRUPET DHE NUMERI I PJESEMARRESVE GJATE TRAJNIMIT

Trajnimi : Plani për EVP në kujdesin primar”

GRUPET	DATA	Numeri I pjesëmarrësve	VENDI
	Fillimi i grupeve gjatë trajnimit katër ditore		
GRUPI 1	18.03.2024- 21.03.2024	12	QKMF PEJE
GRUPI 2	02.04.2024-05.04.2024	11	QKMF PEJE
GRUPI 3	15.04.2024-18.04.2024	12	QKMF PEJE
GRUPI 4	13.05.2024-16.05.2024	12	QKMF PEJE
GRUPI 5	27.05.2024-30.05.2024	11	QKMF PEJE
GRUPI 6	24.06.2024 -27.06.2024	11	QKMF PEJE

Gjate trajnimit - Plani për EVP në KPSH

Jane trajnuar 6 grupe 69 pjesëmarrës ,infermiere dhe profesioniste tjerë shëndetësor që janë të punësuar në kujdesin parësor në QKMF-QMF-AMF ,Klinika stomatologjike në Peje dhe janë pajisur me 20 pike akredituese

raporti Vjetor I Vërtetimeve për praktiken e kryer profesionale pranë QKMF-Pejë

Nga Data 04.01.2024 deri 01.07.2024

Kërkesa për lejimin e praktikës Profesionale gjatë Muajve

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
	27	18	17	17	23	10							112

Vërtetimet që lëshohen për marrjen e licencës

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
	27	18	17	17	18	10							112

Shkolla e Mesme e Mjeksisë -120 Praktikant e kanë vijuar praktiken në QKMF-Pejë

Shkolla e Mesme e Mjeksisë Drejtimi Laborant kanë vijuar në QKMF-Pejë 27 Praktikant

Shkolla e Mesme e Mjeksisë-Euro School-150 Praktikant e kanë vijuar Praktiken në QKMF-Pejë

Universiteti I Prishtinës Fakulteti I Mjekësisë -Divizioni I Infermierisë-10 Praktikant kanë vijuar pjesën Praktike

Kolegji UBT ne PEJE 20-praktikant kanë vijuar pjesën Praktike ne QKMF

BURIMI:

Këto shënime janë marrë nga arkiva e Qkmf-Pejë ,prandaj edhe janë të sakta dhe të protokoluara

P

KRYINFIERMIERE NE QKMF

Msc Rajmonda Elshani

- Vërtetimet që lëshohen për marrjen e licences 135
- Praktiken profesionale nga Shkolla e mesme e mjekësisë 120
- Praktiken profesionale nga Shkolla e mesme e mjekësisë Euroschool 150
- Universiteti I Prishtinës Fakulteti I Mjekësisë divizioni I infermerisë 10
- Kolegji UBT -20

Raporti i komisionit për ankimitin e anekesave nga ana e pacientëve për shqyrtimin e anekesave të pacientve

Gajtë periudhës së parë për muajit Janar, -Qershor 2024

Në shumicën e kutive të lavdatave dhe ankesave nëpër Qmf-ë dhe Amf-ë ishin të zbrazura.

Të gjitha ankesat e drejtuara direct ne zyre dhe arkiv të cilat ishin me emra, numrat e telefonit dhe të letërnjoftiminim i kemi

kontaktuar ,i kemi ftuar dhe jemi takuar me ankuesit dhe me puntorët shëndetsorë ndaj të cilve është paraqitur ankesa .

Ankesat ishin të shkruara dhe kryesisht ishin rreth:

-
- Mosrespektimi i orarit,
- Sjelljet jo të mira të mjekve dhe infermiereve ndaj pacientve ,
- Komunikim jo i mirë mjek pacient, dhe
- Higjiena jo e mirë.

Konkluzionet/ Rekomandimet

- Përvojat e fituara duhet të përdoren në raste tjera emergjente eventuale. Pas përfundimit duhet të përgaditet një plan i veprimit për situata të tilla.
- Duhet gjetur mënyrën për furnizim me gaz medicinal si artikull me rëndësi të madhe në trajtimin e rasteve me theks atyre emergjente.
- Duhet shiquar mundësia për blerjen e aparateve oksigjenues për pacientet ne stadin terminal çka për një periudhe të konsiderueshme do të zgjedhej problemi me furnizim kontinuel me këtë artikull shumë të rëndësishëm.
- Përdorimi i mjeteve për mbrojtje personale dhe dezinfektuesve ka qenë një nga përparsitë
- Duhet të punohet në përkufizimin dhe implemetin e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë aq sa lejonjnë kushtet. Për këtë është formuar edhe grupi punues.
- Duhet të ndërtohet sistemi i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut.
- Implementimi i Sistemit Mbikqyrës Mbështetëse. Edhe këtu është i formuar grupi për implementim.
- Fuqizimi i Komitetit për Ngritjen e Cilësisës së Shërbimeve Shëndetësore si dhe Koordiantorit të Cilësisë.
- Ngritja e vetiniciativës dhe motivimit të personelit në përbushjen e detyrave punuese.
- Mbikqyrja e respektimit të orarit përmes instalimit të aparturaës për hyrje –dalje në të gjitha ISh.
- Furnizimi me uniforma dhe mbathje për të gjithë personelin.

- Aplikimi i Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike të miratura në menaxhimin e pacientëve. Posaqerishte te atij per pershkrimin e antibiotikeve si dhe te manulait te praktikës infermiore
 - Zvogëlimi i përkrahjes së terapisë parenterale.
 - Dërgimi dhe përkrahja financiare i mjekëve por edhe i gjithë personelit në kurse, seminare, kongrese dhe evenimente tjera me interes për QKMF. Formnimi i grupit për realizimit të kornizës së monitorit dhe evaluimit të Master planit.
 - Delegimi i detyrave në përmbushjen sa më kualitative të përgjegjësive dhe obligimeve tek i gjithë stafi e me theks në Përgjegjësat e Departamenteve/Sektoreve si dhe Përgjegjësve në QMF.
 - Përmes indiaktorëve të paracaktuar në mënyrë kontinuele duhet të maten rezultatet dhe performanca në aritjen e objektivave të parashtruara.
 - Aktivitetet në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe njëkohësisht të shiqohet progresi përmes instrumenteve matëse.
 - Monitorimi i zbatimit e aktiviteteteve përmes indikatorëve të paraqitur në planin për vitin 2023.
 - Punësimi i personelit shëndetësor mjek/infermier duke synuar arritjen e standardeve të paracaktuara.
 - Implementim i UA dhe akteve tjera nënligjore të miratuara.
 - Miratimi i Statutit të QKMF në Asamblen Komunale.
 - Vazhdimi i bashkëpunimit me agjencionet nacionale dhe ndërkombëtare si dhe Institucione të nivelit qendror dhe lokal duke u fokusuar në prioritetet dhe planin për vitin 2023.
 - Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të QKMF-së si dhe objekteve tjera.
 - Identifikimi i palëve të interesit si dhe mbajtja e komunikimit me qëllim të realizimit të objektivave me theks në ndërtimin e objektit të QKMF-se si dhe intervenimeve në infrastrukturë .
 - Duhet punuar në fuqizimin e zoonimit si një nga principet kryesore të konceptit të M.F si ofrimin e shërbimeve sa më afër vendëbanimeve të tyre dhe shkarkimin e fluksit dhe presionit në QKMF si dhe do të rritej efektiviteti dhe cilësia e shërbimeve.
 - Fuqizimi i rolit të ekipit të mjekësisë familjare (mjek familjar/infermier/e familjare).
 - Sigurimin e dy ekipeve në Sektorin e Urgjencës, ku njëra prej tyre do të ofron kujdes urgjent në vendngjarje.
 - Angazhimin e Sektorit të Shëndetit Oral në zvogëlimin e prevalencës së kariesit me theks të fëmijët shkollor dhe parashkollor.
 - Mbulueshmëria e fëmijëve në kalendarin e vaksinimit me theks në komunitetet minoritare (Rom).
-
- Implementimi i rrjetit të SISH BHIS në të gjitha Institucionet e KPSH, si dhe ngritjen e cilësisë së futjes së dhënave në databazë.
 - Punësimi i IT për mirëmbajtjen e paisjeve hardverike, softverike si dhe rrjetit të internetit.

- Mbikqyrja e disperzimit të medikamenteve nga LEB planifikimit dhe rerealizimit të planifikimit si dhe regjistrimi në SMSF.
- Racionalizimi i analizave laboratorike bazuar në diagnozë, aplikimi i termineve dhe funksionalizimi i labaratoreve në QMF.
- Aplikimi i i trendeve e reja në menaxhimin e aktiviteteve dhe personelit si implementimi i shpërblimeve por edhe dënimeve sipas legjislacionit.

Dr.Petrit Loci
Drejtor I Shëndetësisë

Pejë 08.07.2024



Datë/Datum/Date	18.06.2024
PËR/ZA/TO	Z.Gazmend Muhaxheri / Kryetar i Komunës së Pejes
NGA/OD/FROM	Arta Nallbani – Drejtoreshë e DUMM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Raport i Punës 6 Mujore (Janar-Qershor)

Gjatë kësaj periudhe kohore DUMM ka realizuar në tërësi planin e punës sipas projekteve të planifikuara dhe të listuara me poshtë sipas prioriteteve:

1. Harta Zonale e Komunës së Pejës

- HZK (Harta Zonale e Komunale) – Ka të miratuar dhe në fuqi Harten Zonale Komunale 2023-2031


2.PROCESI I LEGALIZIMIT TE NDËRTIMEVE PA LEJE

Më datë 01.09.2023 ka filluar afati i ri për aplikimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje pas ndryshim/plotësimit të Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje, Ligji me nr 08/L-184. Afati për aplikim është deri me datën 31 Dhjetor 2025.

KERKESAT E PARAQITURA NË DUUM SIPAS KATEGORISË

Lloji i Kërkesës :	Numri i kërkesave:
Leje të lëshuara të Ndërtimit	110
Kushte ndërtimore	90 të përfunduara Të tjera në proces
Leje Komunale Mjedisore	11
Legalizime	96 kërkesa 56 të legalizuara Të tjerat janë në proces ose listë të pritjes

TE HYRAT NGA LEJET NDËRTIMORE, MJEDISORE DHE LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2023 ËSHTË: TOTAL: 443,592.4€



PËR : Kryetarin e Komunës Pejë

Z. Gazmend Muhaxheri

NGA: Drejtor për Zhvillim Ekonomik

Z. Nasret HAJRIZI

LËNDA: Raporti i punës së Sektorit të turizmit për periudhën
Janar – Qershor 2024

Data: 10.06.2024

Në bazë të kërkesës **Tuaj** dhe duke u mbështetur në planin dhe programin e paraparë të punës për realizimin e punëve dhe detyrave po ju dergojm raportin për periudhen Janar – Qershor 2024 për Drejtoratin për Zhvillim Ekonomik.

SHTOJCA : RAPORTI-JANAR –QERSHOR /2024

VËREJTJE: Raporti i paraqitur është i ndar në tri pjesë ku secila pjesë prezanton veç e veç punën e sektorve në DZHE.

1. RAPORTI I SEKTORIT TË TURIZMIT

1. Është punuar raporti narativ vjetor i punës për vitin 2023, janë bërë vlerësimet e stafit si dhe është punuar programi i punës për vitin 2024.

2. Kemi vazhduar me takimet dhe bashkëpunimet tjera me operatorët e turizmit nga sektori privat për periudhën Janar – Qershor të vitit 2024. Gjatë kësaj kohe kemi takuar mbi 15 biznese të sektoreve të ndryshme të shërbimeve. Qëllimi i takimeve ka qenë i orjentuar në marrjen e sa më shumë informatave për zhvillimet në sektorin e turizmit dhe mundësit e bashkëpunimeve më të afërta në të ardhmen me qëllim të krijimit të një oferte më të konsoliduar dhe më të pasur për të plasuar pastaj në nivel vendi dhe ndërkombëtar.

3. Pjesë e punës ka qenë edhe takimi me OJQ-të nga Peja të cilat kontribuojnë në zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës. Janë diskutuar tema të ndryshme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe mundësit e bashkëpunimeve në projektet e ardhshme si dhe kordinimi i mundshëm i projekteve turistike.

4. Menaxhimi i Zyrës Informative të Turizmit. Kemi vazhduar me punët në kontinuitet për një menaxhim sa më të mirë të këtyre zyreve informative. Janë zhvilluar punë përgatitëse për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve turistike të komunës, shërbimet e nevojshme informative për turistë si transporti, akomodimi, informata rreth shtigjeve etj. Zyret informative janë aktive dhe funksionojnë sipas planifikimeve. Vlen të theksohet se këto zyre janë duke u vlerësuar shumë nga të gjithë akterët e turizmit për punën profesionale si dhe asociacioni i komunave është duke organizuar vizita studimore me drejtorët e zhvillimit ekonomik të komunave tjera për të marrë eksperiencë nga ne.

5. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave të vizitave në zyret informative. Statistikat janë të përpunuara për periudhën Janar – Dhjetor 2023 dhe numri total i vizitorve është

11.657 që kanë kërkuar informacion në zyre, dhe Janar – Maj 2024 kanë kërkuar 3.120 vizitorë.

6. Interpretimi i statistikave nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Në tabelle më poshtë do të gjeni një kronologji të paraqitur nga agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitet 2020 deri 2023.

PEJA	2020		2021		2022		2023	
	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje	Visitor	Netë fjetje
	42.521	97.121	76.013	157.601	74.039	222.652	148.769	653.776

Shënim: Në këtë kronologji shihet se kemi një zhvillim të qëndrueshëm të ritjes së numrit të vizitorve por ajo që vlerësohet është ngritja e numrit të net fjetje të vizitorve. Në vitin 2023 shihet se kemi pasur gati 5 net qëndrimi të një vizitori ndërsa kjo e tregon zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Komunën e Pejës. (krahasim me Prishtinën që një vizitor qëndron 2 netë ndërsa në Prizren 1 natë).


Mdërsa për vitin 2024 deri në muajin Prill kemi 41.203 vizitorë ndërsa netfjetje kemi **117.448**.

7. Edhe në vitin 2024 kemi vazhduar me menaxhimin e rrjeteve sociale të cilat kanë një ndikim të madh në promovime andaj këto media sociale janë shfrytëzuar për qëllim të promovimit në masë më të madhe dhe janë menaxhuar vazhdimisht faqet në:

- **Facebook** - "Peja Tourist Information" Culture ;
- **Instagram** - "Visitpeja" dhe "Pejaturism" ;
- **Twitter** - "Visitpeja" dhe "PejaTourism"
- **LinkedIn** – Peja Tourist Informatoin Office
- **Facebook te projekteve** - "Culture Heritage Treasure of Cross border Region dhe Accursed Mountains Kosovo të cilat gjithashtu promovojn komunën tonë por edhe rajonin;

- Gjithashtu jemi gjithmon të angazhuar në plotësimin e ëeb faqes me të dhëna të reja.

Të gjitha këto kalojn mbi 10.000 ndjeks ndërsa vizitueshmëria arrin mbi 100.000 ndjekës.



8. Kemi vazhduar bashkëpunimi me MINT-Divizionin e Turizmit. Kemi qenë pjesë e zhvillimeve dhe bashkëpunimet tjera në furnizimin me materjal promovues për pjesëmarrje në panaire si dhe pjesë e zhvillimit të platformes online të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

9. Kemi zhvilluar takime me organizatën SwissContact me të cilët kemi biseduar për zhvillimin e punëve dhe projekteve. Kemi nënshkruar MoU për certifikimin e produkteve turistike, punimin e hartës turistike si dhe marrëveshjen për punimin e strategjis së turizmit.

10. Ka vazhduar bashkëpunimi me grupin kordinues në mes të Pejës, Shkodrës dhe Plavës për projektin “Majat e Ballkanit”. Gjithashtu në bazë të vlerësimeve nga Tour Operatorët viti 2024 do të jetë gjithashtu një vit i mirë për numër të vizitorve në shtegun Majat e Ballkanit. Gjithashtu kordinime ka pasur edhe me projektet tjera si “Culture Heritage Treasure of Cross border Region” dhe “Accursed Mountains Kosovo”.

11. Kemi marr pjesë aktive në grupin punues për hartimin e dokumentit për Menaxhimin e “Çarshisë së Pejës” e cila është udhëhequr nga OSBE dhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë.

12. Me ftesë të EU projektet IPA cross border kemi marrë pjesë në takime të ndryshme në promovimin e projekteve ndërkufitarë, ndërsa në si drejtori kemi prezantuar në konferenca is shëmbull sukcesi në menaxhimin e projekteve dhe vazhdimin e mirëmbajtjes së projekteve.

13. Së bashku me kryetarin kemi qenë pjesë e takimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të 5 komunave ndërkufotare për bashkëpunim të përbashkët. Komuna janë Peja, Deçani, Juniku nga Kosova, Plava dhe Gucia nga MALi i zi dhe Tropoja nga Shqipëria.

14. Kemi zhvilluar takim e të ndryshme me Universitetin Publik “Haxhi Zeka” për bashkëpunim ne Forumin Ekonomik Rajonal si dhe jemi në procesin e ndërtimit të Inkubatorit të Biznesit.

15. Kemi marrë pjesë në viziten studimore ne Grenoble në Francë të organizuar nga SwissContact dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Vizita është organizuar për disa komuna të Kosovës dhe pjesmarrës kanë qenë edhe kryetarë dhe drejtor të Zhvillimit Ekonomik. Qëllimi i viztës ka qenë marrja e eksperiencave të mira në zhvillimin e turizmit si dhe pjesmarrja në panairin e Grenoble si një ndër panairët më të mdha në Evropë për aktivitete në natyrë.

16. Kemi pasur takim me organizatën UNDP ku kemi pritur zyrtarët nga kjo organizatë dhe ekspertët nga Austria dhe Sllovenia me të cilët kemi diskutuar për zhvillimet në turizem e sidomos për ofertën e turizmit rural në Pejë.

17. Jemi ne takim të vazhdueshëm me Organizatën CDF ku në bashkëpunim me ta do të organizojm Panairin Verorë me 40 pjesmarrës të produkteve lokale duke e shëndruar në një ofertë unike që prezantoj arritjet e Pejës dhe rajonit, por edhe prezanton ofertën atraktive të qëndrimit në Pejës përmes ngjarjeve që do të zhvillohen në mbrëmje gjatë 3 ditëve.

PROJEKTET ME BUXHET KOMUNAL

Jemi ne proces të shpalljes së tenderve ndërsa disa janë duke u realizuar.

Projektet për vitin 2024 janë:

- Hartimi i projektit per Zip Line dhe Kroje dhe Lugje – Projekti është duke u zhvilluar
- Materjale Promovuese - Projekti është duke u zhvilluar
- Panairi Veror – Projekti është duke u zhvilluar
- Panairi Dimëror - Pritet të dërgohet për prokurim
- Ndërtimi i Muzeut të Bjeshkatarisë- Është punuar Projekti kryesor për ndërtim dhe pritet të zhillohen procedurat e prokurimit
- Ndërtimi i Zip Line në zonën e Podgurit – Pritet të përfundoj projekti dhe të fillojm me procedura të prokurimit
- Ndërtimi i krojeve në bjeshëkt e Jabllanices, Gllavicicë, Radac dhe Lipë – Pritet të përfundoj harimi i projekte dhe të vazhdojm me procedura të prokurimit.

Në proces të punës gjithashtu janë:

- Projekte në Proces: Turizmi i Aventurës – Projekti në bashkëpunim me MAPL (pjesa e MAPL ka përfunuar dhe një pjesë e komunës është duke u realizuar).
- Ndërtimi i strehimoreve në shtigjet turistike (ky projekt dy herë ka qenë i tenderuar). Në tenderimin e parë nuk ka marr pjesë askush ndërsa në heren e dytë është shpall fituesi por ka pasur ankesa kështu që ka ndikuar që ky projekt për shkak të motit të keq të bartet për vitin 2024. Jemi duke pritur lejen nga

Agjincioni i Pyltariisë pasi që ata janë pronar të tokës ku do të ndërtohen strhimoret.

PROJEKTET ME DONATORËT TJERË

Projektet në përgjithsi janë duke u implementuar në mënyrën më të mirë të duhur. Nuk ka ndonjë vërejtje sa i përket rrjedhës së projekteve.

Projektet me fondet e EU – Programi ndërkufitarë Kosovë – Mali i Zi

Tani si drejtorat jemi përfitues të dy projekteve të reja ndërkufitare nga forndet IPA-2 2020-2022 dhe bashkëfinancuar nga komuna e Pejës të cilat duhet të zhvillohen në afatin 2022 – 2024.

- **NERA – New Environment Revitalization Approach** - me vlerë prej 479.027 ku vlera për pjesën e Pejës është 223.774 ndërsa participimi i komunës është 42.900 Euro

Përmes këtij projekti kemi furnizuar kompanin e pastrimit “EkoSig” me pajisje të nevojshme si shara të ndryshme, trimer, kolica, lopata uniforma dhe kërkesa tjera. Gjithashtu do ti furnizojm me thithëse pluhuri automatike si dhe më një kamionet që do të shërbejn për një menaxhim më të mirë të punës dhe për një qytet më të pastër. Përmes këtij projekti kemi realizuar edhe “Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2028” si një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Pejës.

Gjithashtu në 6 shkolla janë mbajtur trajnime për vetëdijësim për ambient ndrsa ato 6 shkolla dhe 4 institucione tjera publike do të përfitojn nga 4 kontiner të vegjel plastik (në përgjithsi 40) për sortim të mbeturinave. Projekti parasheh të vendosen edhe 40 shporta të mbeturinave nga metali përgjatë lumit Lumbardhi dhe do të bëhet pastrimi i 10 hapësirave ilegale me mbeturina të cilat do të pajisen edhe me kariga dhe mbjelljen e pemve duke i shënruar në oaza të gjelbërta.

Gjithashtu përmes këtij krojekti kemi pasur bashkëpunim me kompanin rajonale “Higjena” ku kemi organizuar vizita studimore në Tuz për të shkëmbyer eksperiencia në

menaxhimin e mbeturinave. Këtë kompani e kemi furnizuar me 5.040 qese plastike për ti ndarë në 840 familje me qëllim të ndarjes së mbeturinave.

- **Turning our village in tourism destination** - me vlerë prej 456.106 Euro ku vlera për pjesën e Pejës është 228.000 dhe participimi i komunës është 34.208 Euro

Përmes këtij projekti kemi zhvilluar trajnime për banorët lokal në zonat rural të cilët ofrojnë akomodime ndërsa aktivitetet tjera nga ky projekt kanë të bëjnë me zhvillimin e shtigjeve të ciklizmit në zonat rurale, sinjalizimi i tyre, sinjalizimi trashëgimis kulturore, interevenimi në regullimin e hapësirave publike në fshatra, si dhe ndihma e banorve lokal për krijimin e kushteve më të mira për pritjen e vizitorve.

Gjithashtu projekti parasheh edhe pjesën e promovimit të ofertës turistike dhe përmes këtij projekti do të ngrisin diversitetin e destinacionit turistik të Pejës duke e bërë një destinacion atraktiv për vizitor.

Projekti NATURKOSOVO

Projekti është iniciativë e qeveris Italiane e cila e ka dhuruar fondin ndërsa implementues të projektit do të jenë organizatat Italiane CESVI dhe CELIM. Projekti ka të bëjë me zhvillimin e turizmit malorë në komunat Pejë, Deçan dhe Junik. Projekti parasheh zhvillime të reja në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerzore përmes trajnimeve, intervenim në infrastruktur dhe promovim të destinacionit dhe kap vlerën 1.800.000 Euro. Projekti ka filluar implementimin dhe është bërë vlerësimi i shtegut Via Dinarica, janë zhvilluar trajnime për kërkim shpëtim. Tani është faza ku janë përcaktuar përfituesit nga stafi i projektit dhe do të ndahen grante për biznese dhe shoqata në tri komunat Pejë, Decan dhe Junik. Përmes këtij projekti do të investohen edhe 40.000 Euro që kanë filluar të punohet në regullimin e strehimorës të kilometrin e 5'të si dhe murin zbkurues ndërsa pritet të vazhdojnë punimet në ujvaren e Shtupeqit të Madhë.

PROJEKTI "TOURISM FOR FUTURE" - Është projekt ndërkufitar më Malin e Zi ndërsa komuna është bashk-financuese. Projekti ka të bëjë me Certifikimet e destinacionit dhe bizneset me standardin internacional EcoLabel duke krijuar mundësi të menaxhimit të vetqëndrueshëm të turizmit në Pejë. Edhe ky projekt parasheh ngritje të kapaciteteve

njerzore, infrastrukturë të lehtë, zhvillimi i aktiviteteve për çertifikime dhe promovim të Pejës si destinacion të qëndrueshëm dhe EcoTurizem. Projekti ka përcaktuar 9 përfitues që do të certifikohen. Në si drejtorat bashkarisht me këtë projekt kemi organizuar edhe festivalin e Turizmit “Peja Tourism Outdoor Festival” që ka bërë bujë të madhe në promovimin e destinacionit tonë për turizmin e aventurës.

2. SEKTORI I REXHISTRIMIT TË BIZNESEVE.

Datë . JANAR/QERSHOR-2024

Nr.	Aktivitetet	Numri	Verejtje
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	287	SHPK -206 SHA - 2 BIZNES INDIVIDUAL 79
2	Ndryshime ne biznes	113	
3	Shuarje te biznesit	17	
4	Kerkesa te Ndryshme Vertetime, ndrrime te certifikatave etj.	261	
Gjithësejt të perpunuara :			443 lëndë

3. SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK

Në Këtë sektor perveq puneve të perhershme qe i ka ky sektor për here të parë pas shumë vitesh kemi bërë ndarjen e subvencioneve për **startup** bizneseve , ku vlera e teresishme e ketijë aktiviteti eshte **50** mijë euro me gjithsej **34** perfitues.

Datë : JANAR/QERSHOR-2024.

Nr.	AKTIVITETI ▼ PERIUDHA ►	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
1	Licenca për Alkool	06	17	22	15	09				
2	Licenca Speciale	01	02	//	//	01				
3	Licenca për Auto Taxi	08	12	09	10	09				
4	Licenca për Radio Taxi	//	//	01	01	01				
5	Licenca për Autobus	//	//	//	//	//				
6	Rendi i Udhëtimit	//	//	//	//	//				
7	Vërtetim për Pension	08	07	05	04	05				
8	Referenca	//	//	//	//	//				
9	Refuzime	//	//	//	01	//				

	Lënd të procesuara gjatë muajve	23	38	37	31	25				
--	--	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	--	--	--	--

4. Problemet

Drejtoria për zhvillim ekonomik gjatë vitit 2023 e poashtu edhe në vitin 2024 është ballafaquar dhe duke u ballafaquar me mjaft probleme të natyrave të ndryshme që kanë shkaktuar vështirësi në zhvillimin e aktiviteteve të parapara në planin e punës.

Një nga problemet është mungesa e Strategjis për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Mungesa e stafit po e bënë mjaft të vështirë funksionimin e kësaj drejtorie. Pjesa e sektorit të turizmit në të cilën janë të pozicionuara projektet ka munges të stafit së pari për ta mbajtur hapur zyrën për Informacion Turistik edhe në vikende e gjithashtu në menaxhimin e kontratave ku një punëtor duhet të angazhohet me shumë punë të natyrave të ndryshme si në menaxhimin e zyreve informative, realizimin e projekteve infrastrukture, përcjellja e projekteve me donacionet e huaja, pjesëmarrj në takime strategjike, vizitat në terren etj etj. Gjithashtu në munges të stafit edhe në dy sektoret tjerë jemi të hendikepuar në pjesmarrjen e shumë takimeve strategjike si dhe trajnime për ngritjen e kapaciteteve njerzore.

Menaxhimi i kontratave është gjithashtu një sfid që i përcjell stafin e drejtoratit. Mungesa e trajnimeve për menaxhim të kontratave online ka bërë që puna jonë të jetë shumë më e vështirë në këtë drejtim.

Mungesa e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve njerzore. Stafi nuk ka trajnime të cilat do të ndikojn në ngritjen e cilësis së menaxhimit edhe pse çdo vitë i kërkohet dhe i dergojn se çfar lloj trajnime kanë nevoj ti ken.

5. Rekomandim

Rekomandojm që në të ardhmen të mundësohet punësimi i së paku 4 (katër) personave që do të udhëheqin punë specifike në sektorin e turizmit, të trajtohen disa mundësi së paku për trajnime të stafit me qëllim të profesionalizimit për një menaxhim më të mirë.



ZYRA E PERSONELIT

Pejë, me 14.06.2024.
Zyrtarisht

P ë r : Kryetarin e Komunës Gazmend Muhaxheri .

N g a : Zyra e Personelit

Lënda: Raporti për përudhen 6(gjashte) mujore për vitin 2024

Njësia e personelit në periudhën kohore 05.01.2024-13.06.2024, i ka kryer të gjitha detyrat e punës të cilat janë në përgjegjësi dhe fushëveprim të kësaj njësie duke i respektuar dhe duke iu përmbajtur dispozitave ligjore pozitive si dhe konform politikave të personelit të parapara me Planin e personelit për vitin 2024.

Më poshtë janë të paraqitura të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe 6 (gjashtë) mujore për vitin 2024.

1. Bazuara në Planin e Personelit për vitin 2024 me të cilat janë paraparë zhvillimi i procedurave për plotësimin e vendeve të punës të cilat vende janë të zbrazëta si pasojë e pensionimeve, dorëheqjeve, largimeve, vdekjeve etj. Janë publikuar gjithsejtë: 1(një) konkurse procedur e cila ka përfunduar përmes sistemit HRMIS si dhe 5 (pese) konkurse janë në procedur .

1.1. Konkursët e jashtëme

Ligji Nr. 08/L-197 i Zyrtareve Publik i Republikës së Kosovës, në dispozitat e tij ka të parapara për plotësimin e vendit të punës së pari të fillon **me Konkursët e jashtëme Njësia e Personelit për vitin 2024 ka zhvilluar gjithsejtë 1 (një) Konkurse te jashtëm e e cila ka rezultuar e suksesshme ku pozita është plotësuar nga zyrtarja e mëposhtëm siç është;**

1.Samka Dranqolli - Zyrtar për Barazi Gjinore –Kabineti i kryetarit

Konkursët ne procedurë janë:

-Zyrtar Ligjor –Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

-Zyrtar i Larte për Çështje Pronësore Juridike –Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike

- Zyrtar për Evidentimin e Pronës – Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyrtar për Teknologji Informative –Drejtoria per Arsim
- Zyrtar për Prokurim –Zyra e prokurimit

Përveç zhvillimit të procedurave rekrutuese, Njësia e Burimeve Njerëzore ka edhe aktivitete tjera të cilat zhvillohen varësisht nga kërkesat e zyrtareve lidhur me nevojat e tyre.

Në vitin 2024, 4 (katër) zyrtarëve civil ju ka përfunduar marrëdhënia e punës, me plotësimin e kushtit ligjor arritjen e moshës së **pensionimit** (65 vjet), ku me këtë ju është bërë Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies për ish zyrtarët e poshtë shënuar.

- **Afrim Loxha - Drejtoria për Inspektion**
- **Shaban Muriqi - Drejtoria për Inspektion**
- **Hava Murati - Drejtoria për Buxhet dhe Financa**
- **Veton Agusholli - Drejtoria për Administratë**

Pushime të lehonisë kemi vetëm 3 (tre) raste për zyrtarët :

- Anita Mazreku Husaj** -zyrtare në Drejtorin për Mirëqenie Sociale
- **Anela Hukic** -Zyra Komuna për Komunitete dhe Kthim
- Adelina Kovaqeviq Kelmendi** - Asistente pran zyrës së Kryetarit

Rastet e vdekjes

- **Nexhmije Mavraj -Drejtoria për Mirëqenie Sociale**
- **Aver Husaj -Drejtoria për Kulture Rini dhe Sport :**

Dorëheqje nga vendi i punës kanë dhënë 2 (dy) zyrtar në drejtori të ndryshme:

- **Tivar Gashi-** Drejtoria për Administratë (dorëheqje)
- **Shkelzen Dreshaj** - Drejtoria për Çështje Pronësore Juridike (dorëheqje)

Pezullimet me 50% të pagës me vendim të gjykatës 2 (një) zyrtar

- **Florije Berisha** - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit .
- **Adhurim Kasapi**-Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi

Numri i Transferimeve të Jashtme kanë qenë 2 (dy) raste:

- Ajtene Ternava Salihu** - Transfer Komuna e Vushtrrisë .
- Kreshnik Smajli** -Transfer Komuna e Pejës .
- Agron Bobi** -Transferohet ne Agjensionin e Pylltarisë
- Shaim Alimehaj** -Transferohet ne Agjensionin e Pylltarisë
- Ismet Shabanaj** -Transferohet ne Agjensionin e Pylltarisë

Numri i Transferimeve të përhershme për nevoja të Institucionit kanë qenë 9 (nëntë) raste:

- **Januz Hajzeraj**- Transferohet në pozitën - Zlp për Performanc Komunale - Kabineti i Kryetarit
- **Shqipe Shala** - Transferohet në pozitën - Zlp për Planifikim dhe Projekte- Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi
- **Rudina Vokshi Veliu**- Transferohet në pozitën -Zyrtar Ligjor-Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi .
- **Fiona Berisha** - Transferohet në pozitën - Zyrtar ligjor -Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi .
- **Shqipe Gjuka** - Transferohet ne pozitën - Zlp për Arsim të Mesëm të lartë- Drejtoria për Arsim
- **Dren Shala** - Transferohet ne pozitën - Zyrtar për Shërbim me Qytetar
- **Donjeta Berdynaj** - Transferohet ne pozitën - Zyrtar Shpenzues dhe i Pasurisë
- **Veton Dervishaj** - Transferohet ne pozitën - Inspektor komunal

Kërkesa për pushime vjetore për vitin 2024 dhe ditë të mbetura nga viti i kaluar kanë qenë 299 , pushime për të cilat edhe janë nxjerr vendime për aprovime apo refuzime.

Ndërsa kërkesa për pushime mjekësore kanë qenë 36, për të cilat edhe është nxjerrë Vendime.

Me kërkesën e Njesisë së Personelit, është proceduar 1 (një) raste i zyrtarit në komision disiplinor, me çka Komisioni nuk ka zhvilluar procedurën për shkak se nëpunësja Hatka Hadzic edhe ankuar në KPMSHCK .

Janë lëshuar një numër i madh i vërtetimeve të natyrave të ndryshme për të punësuarit, për ish të punësuarit etj. varësisht prej nevojave dhe kërkesave të parashtruara nga ata. Po ashtu rregullisht kemi dërguar raportet e rregullta dhe ato sipas kërkesës në MAP dhe MAPL-së, lidhur me zhvillimet në Komunën e Pejës. Kemi bërë shumë organizime dhe mbledhje të komisioneve të ndryshme, mbajtje të procesverbaleve të ndryshme, organizime të trajnimeve, hartime të planeve nga fusha e personelit .

Vlen të theksohet puna dhe angazhimi në kompletimin e dosjeve të personelit në SIMBNJ (sistemi elektronik i dizajnuar për këtë qëllim), HRMIS, punë e cila vazhdon edhe në të ardhmen.

Me respekt,

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim		 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA	PERIUDHA RAPORTUE SE
Sabahudi Cirikovic sabahudin.cirikoviq@rks-gov.net 045 724 000			TM 2 / JAN – QER
			DATA: 12.06.2024

Nr. Ref.	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës e për Janar –Qershor 2024	Muaji i realizimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1	<p>Monitorimi ditor i sistemit online të Ministrisë Punëve të Brendshme për personat e riadhesuar në orën 08:00 dhe 14:00.</p> <p>Ne sistemin për menagjimin e rasteve (SMR) janë pranuar 4 raste të riadhesimit.</p>	Janar- Qershor	
2	<p>Monitorimi ditor i Intranetit (Sistemi Elektronik) – 5 kërkesa 2 miratuara – 3 refuzuar.</p>	Janar- Qershor	
3	<p>Bashkëpunimi me nivelin qendror të MPB-së si dhe me zyrën rajonale të MPB-së lidhur me procesin te riadhesimit :</p> <ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi (konsultimet) me koordinatorin rajonal nga zyra MPB-ës, lidhur me verifikimin në terren brenda 5 ditëve të personave të riadhesuar sipas rregullores nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të kthyer dhe për menaxhimin e programit të riintegrimit. Bashkëpunimi me MPB -sektorin e menaxhimit të rasteve rajonale, lidhur me verifikimin e të dhënave të rasteve të riadhesuar si dhe plotësimin e të dhënave të të njëjtit në sistemin online. 	Janar- Qershor	
4	<p>Bashkëpunimi me nivelin qendror të MKK-së</p> <ul style="list-style-type: none"> Takimet e rregullta me MKK-në lidhur me procesin e kthimit dhe zgjidhje të qëndrueshme. Takim me përfaqësuesit e MKK-së me temën: <ul style="list-style-type: none"> Procesi i kthimit ne Kosovë. Takimi dhe bashkëpunim lidhur me online sistem 	Janar- Qershor	
5	<p>Bashkëpunimi me nivelin qendror</p> <ul style="list-style-type: none"> Trajnim organizuar nga Ministria e Puneve të Brendshme MPB-DRPRIH, me temen: Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale. 	Janar- Qershor	
6	<p>Bashkëpunimi me Policin e Kosovës dhe FSK-në</p> <ul style="list-style-type: none"> Takime të rregullta mujore për çështje të komuniteteve ne komunën e Pejës. 	Janar- Qershor	

	Kampanja për konkursin e ri të shpallur nga FSK për rekrutimin e kadetëve për vitin akademik 2024/2025		
7	<p>Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim me IOM-in për projektin e stabilizimit të komuniteteve (kampanja për konkursin e ri) • Ne kuader të programit stabilizim i komunitetve EU –CSP IV, është pajisur me laborator (biologji, kimi, fizik dhe gjeografi) ne shkollen e mesme Gjimnazi “Bedri Pejani” Pejë • Po ashtu ne kuader të programit stabilizim i komunitetve EU – CSP IV, është pajisur me laborator (biologji, kimi, fizik dhe gjeografi) ne shkollen fillore “7 Shtatori” Vitomericë • Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – OSBE Ka organizuar trajnim ne bashkpunim me Ministrin e Punëve Brëndshme, me temen: Parandalimi e ekstemizmit të dhunëshem dhe radikalizmi që qon ne terrorizem. • Trajnim organizuar nga OSBE ne bashkpunim me zyren për qeverisje të mirë, me temen: Prezentimi i raportit per vitin 2023 për zbatimin e strategjisë për avansimin e të drejtave të komunitetve rome dhe ashkali ne republiken e Kosovës 2022-2024 dhe plani i veprimit 2022-2024. • Projekti – Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë – MARDI Ka mbajtur trajnim dy ditorë më temen: Implementimin e Planve Komunale të Veprimit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve. • DEMOS – Ka organizuar trajnim me temen: Buxheti i shërbimeve për grupet e marginalizuara. • Trajnimin për Udhëzuesin për Monitorim dhe Vlerësim të Zbatimit të Politikave të Integrimin të të Huajve dhe Qasjes së Tyre në Skemat e Integrimin të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, mbështetur nga Jesuit Refugee Service - Kosova. 	Janar- Qershor	
8	<p>Bashkëpunimi me drejtoritë komunale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje ne Komision Komunal për Riintegrim (KKR) • Komiteti për Komunitete (KK) • Komitet për politik dhe financa (KPF) • Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) • Kuvendi Komunal 	Janar- Qershor	
9	Ofrimi i asistencës, shërbimeve dhe dhënies së informacionit për palët dhe verifikimi në teren.	Janar- Qershor	

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se caktohen zyrtar përgjegjës të cilët duhet kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Po ashtu të sigurojë se OJQ-të përfituese të subvencioneve dorëzojnë raporte financiare dhe narrative.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.	Janë ndërmarrë veprime të pjesëshme.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter-konfirmimi - Peje



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KK-Pejë për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Gazmend Muhaxheri, Kryetar i

Data: 14 qershor 2024



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020. Kryetari i Komunës më datën 09.07.2024, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I Propozohet Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim, që projekti "Përkrahja e fermerëve-bujqëve ne zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim (aneks për fermerët në listën e pritjes, aplikues në thirrjen publike të datës 08.04.2024). Komuna 70% dhe participimi i fermerëve 30%, që i njejti material të dërgohet në Kuvend për informim për anëtarët e kuvendit.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arkives

L.nr. 400/01/153073 2024
Pejë, 09 Korrik 2024

KOMUNA E PEJËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 05.07.2024, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit Komunal ta shqyrtoj raportin informativ të Drejtorisë së Arsimit, lidhur me përfundimin e vitit Shkollor 2023-2024, Testit të arritshmëris dhe Testit të Maturës 2024.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Arsim ,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

I.nr.400 01/152389 / 2024
Pejë, 05 Korrik 2024

KOMUNA E PEJËS



Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokoll nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 05.07.2024, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit Komunal ta shqyrtoj raportin e punës së ekzekutivit të Komunës për periudhën 01.01.2024 deri me 30.06.2024.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

L.nr.400 01152348 / 2024
Pejë, 05 Korrik 2024

KOMUNA E PEJËS


Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEÇ



Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 05.07.2024, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar – qershor 2024, procedim të mëtejshëm në Asamblenë Komunale si material **Informativ**.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

I.nr.400 d/52380 / 2024
Pejë, 05 Korrik 2024

KOMUNA E PEJËS




Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRFCEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 05.07.2024, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj Raportin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Planit të veprimit për të gjeturat e Auditimit të vitit 2023, nga Zyra Kombëtare e Auditimit, procedim të mëtejshëm në Asamblenë Komunale si material **Informativ**.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

I.nr.400 01152385 / 2024
Pejë, 05 Korrik 2024

KOMUNA E PEJËS



Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI

Dt. 09.07.2024

Projekti “Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim” (aneks)

Ky projekt do të realizohet sipas Thirrje Publike të datës 08.04.2024 - **Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim (aneks për fermerët në listën e pritjes, aplikues në thirrjen publike të datës 08.04.2024).**

Për implementimin e këtij projekti (aneks e thirrjes publike të dt. 08.04.2024), ku Komuna do të mbështesë fermerët më 70% të vlerës së përgjithshme ndërsa fermeri do të participojë më 30%.

Qëllimi i këtij projekti është mbështetje e qëndrueshme e ekonomisë familjare në zonat rurale të Komunës së Pejës.

Subvencionimi përfshinë:

1. Freza 1.8m – 25 përfitues;
2. Freza 2.0m – 24 përfitues;
3. Spërkatëse – 16 përfitues.

Mbështetja institucionale për këtë sektor – kultivues të drithërave (që duhet t’a dëshmojnë nëpërmes aplikimit për subvencione (MBPZhR-AZhB) dhe që planifikojnë mbjelljen e këtyre kulturave – drithrave për vitet në vazhdim) është më se e nevojshme për të fuqizuar edhe më tej bujqitë e komunës sonë. Po ashtu, kjo mbështetje për kultivimin e drithrave do të lehtësojë punën në ekonominë familjare të bujqëve/fermerëve.

Nga ky projekt do të përfitojnë banorët e Komunës së Pejës në bazë të të mbjellurave - drithrave.

Në total vlera e projektit është **48,080.00€**.

Forma tabelare e projektit:

Përshkrimi	Sasia	Çmimi për njësi	Totali i çmimit
Freza 1.8m	25 përfitues	800.00€	20,000.00€
Freza 2.0m	24 përfitues	810.00€	19,440.00€
Spërkatëse	16 përfitues	540.00€	8,640.00€
TOTALI			48,080.00€



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI

DATË/A	09.07.2024
PËR/ZA/TO	Kryetarin z. Gazmend Muhaxheri
CC	z. Afrim Shala – jurist, KK Pejë
NGA/OD/FROM	DBPH, drejtori: z. Tahir Shala _____
TEMA/SUBJEKTA/SUBJEKT	Kërkesë që Projekti “ Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim” (aneks për fermerët në listën e pritjes) të jetë pikë e rendit të ditës në seancën e muajit korrik

Kërkojmë nga Kryetari i Komunës z. G. Muhaxheri, që për seancën e muajit korrik, projekti **“Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim” (aneks për fermerët në listën e pritjes, aplikues në thirrjen publike të datës 08.04.2024)** të jetë pikë në rendit të ditës.

Ky projekt do të realizohet sipas Thirrje Publike të datës 08.04.2024 - **Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim, Komuna 70%, dhe participimi i fermerëve 30%.**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-45824

Pejë, datë: 18 qeshor 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i -VI- i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **18 qeshor 2024**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Drejtori për Çështje Pronsore Juridike, z.Arianit Krasniqi, Drejtori për Zhvillim Ekonomik, z.Nasret Hajrizi, Zyrtare kryesore financiare, znj.Hajrije Haxhijaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, Zyrtare Administrative, znj.Donjeta Morina, Asistente e kryesuesit, znj.Florlinda Berisha, dhe përfaqësuesit e ZIP-it dhe OSBE.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë dhe po ashtu sqaroi që u shtu një pikë shtesë “Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratim të propozimi vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.protokollit 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik”.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 9 vota pro, kundër nuk ka, të përmbajtur nuk ka.

Rendi i Ditës

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.05.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
4. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratim të propozimi vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.
7. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 16.05.2024

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt.16.05.2024.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: pas qarkores së parë nga ministria, formimi i grupi punues nga zyrja e kryetarit, gjithashtu diskutimi publik që është mbajt dhe eështë përgatit materiali për kornizen afatmesme buxhetore për vitin 2025-2027.

Z.Labinot Panxha: unë siq jam shprehur edhe në seancën e parafundit në kuvendin komunal, respekt për zonjen e nderuar mirëpo unë po mendoj që këtu ishte dasht me ardh drejtoresha e buxhetit dhe financave, siq janë ktu edhe drejtorat e tjerë. Sepse ne këtu jemi të emruarit politik dhe po ashtu edhe na presim që të emruarit politik të vin këtu, me i sqaru dhe me i disku ato pika të cilat janë në rend dite. Drejtoresha është zgjedhe dhe po mendoj që e udhes është me qenë këtu, sepse një shërbyes civil nuk mendoj që duhet me na raportu neve, pa mar parasysh pozicionit të saj që e ka si zyrtare kryesore financare dhe kam shumë respekt për zonjen mos e mer personale nuk kam asgjë kunder me juve, vetëm se është çështja që duhet me ardh i emruari politik me raportu ktu!

Znj. Zize Hakaj Veselaj: në material nuk e pash askund prej mandati te kaluar ka qenë projekti ndertimi i stadiumit në fshatit Raushiq, pse nuk është stadiumi i Raushiqit?

Z. Berat Ganiqi: unë krejt çka pashë është se shumë projekte që kanë pas me u kry janë shty, psh është palestra sportive në Zahaq! Kur ka fillu me u ndërto iu bojshin urimee palestra ndërsa palestar askund dhe e pash që po bartet diku tek 2026-2027, zgjatet edhe ma vonë sepse edhe njëhere e kemi pas njejt. Ka projekte të tjera po ashtu edhe projekti i sheshit “ Haxhi Zeka” që është parapa një” milion” here ai investim, edhe ajo dmth është e bartme. Ky është shqetësimi im, e kuptoj që komuna ka mbet pa të holla për shkak të dënimëve që i ka pas në gjykat, mirëpo siq e kam thën edhe në seanc, po e them edhe tash që nuk jan tregu shtëpiak të mirë në menaxhimin e buxhetit dhe kjo është duke ndodhë edhe më tutje! Shumë rrugë prap nuk kanë emër se në cilen

rrugë investohet, a investohet në Pejë, a në Dardani, cila rrugë? Po ashtu edhe unë kam vërejtje për mos ardhjen e drejtoreshës së financave, po mendoj që ajo e ka marr një besim politik, pa keqkuptim ZKF nuk muj me kritiku në mënyren e vet është profesionale, mirëpo ne jemi persona politik dhe kam qejf me u ballafaqu me njerzë politik.

Z. Mentor Bajri: unë, e kam një mendim ndryshe nuk ka rëndsi se kush vjen a drejtoresha, me rëndësi është me mar përgjigjen opozita nese e ka bo ndonjë pyetje konstruktive.

Z. Berat Ganiqi: unë, po pajtohem me kolegun Mentor, sikur ministri kur të vjen kryetari me qit ndonjë zyrtar të stafit civil me taku kryetarin a është në rregullë? Jo, nuk është në rregullë dhe nejt i bjen nuk është në rregullë dikush me u përgjigjë nga stafi civil, sespe kta janë staf civil ndrohet pushteti por kta mbesin, përgjegjësini politike e ka marr një parti, udhëheqjen e një drejtorati e ka marr një drejtoreshë/drejtor dhe përgjigjet duhet me i sjellë ata, dhe në rast që mungon drejtoresha dhe ka një arsye familjare, arsye tjera athere mund ta zëvendsojë!

Znj. Hajrije Haxhijaj: sa i përket pjesëmarrjes së drejtoreshës deshta vetëm me cekë se me ligj mbi menaxhimin e financave publike, ZKF-ja mundet me zëvendesu drejtorin për buxhet dhe financa. Sa i perket sqarimit të kornizes afatmesme buxhetore, korniza buxhetore është punu në bazë qarkores së parë buxhetore apo në bazë të shpenzimeve afatmesme të qeverisë ku janë cek edhe objektivat dhe prioritetet e komunes së Pejës. Buxheti për vitin 2025 është 39, 639.882 euro ku kemi një rritje prej vitit 2024 5.96 %. Ku pjesmarjen e të hyrave vetanake të cilat mendohet te i inkasoj komuna e Pejës është 14.09%. Nuk po e cek krahsushmerinë e buxheteve sipas grandit të përgjithëshem dhe gradit specifik të arsimit dhe shendetësisë, dhe financimit të teatrit. Sa i perket të hyrave të tatimit në pronë ketë vit kemi pas pak zbritje te tatimi në pronë, duke mar parasysh që është zbrit norma e tatimit në pronë, ku është zbrit edhe amortizimi te objektet ku ka qenë 15 mijë tani është bë vlera 30 mijë, prej 0.15 % është bë norma 0.10% te tatimi në tokë. Kemi një zbritje prej tatimit në pron rreth 300 mijë euro sa i perket të barjtes të hyrave vetanake në pronë. Shihet në tabele në faqel 11, dhe po ashtu është bë ndarja e objektev promare dhe sekondare ku edhe ajo e zvoglon shumen e tatimit në pronë. Te hyrat e pergjithëshme të cilat kanë me u mbledh në vitin 2025 janë diku rreth 5,593,510.00euro, në vitin 2026 janë 6,055,214.00euro dhe në vitin 2027 6,523,987.00 eruo. Sa i perket te projektet kapitale ktu jemi mundu dhe mendoj që është bë një shpalosje e mirë e projekteve kapitale për vitin 2025, ku janë të cekura rrugët të cilat kanë me u asfaltu, dhe janë të cekura participimi prej përfomancës që e kemi mar ketë vit 1 milionë e 800 mijë euro ku është si fond 2 vjeqar, dhe mendojmë mjetet nga kuvendi i komunal të ndahen për vitin 2025 për realizmin e ketyre projekteve. Po ashtu janë edhe projektet të cilat janë nënshkru marrveshje me heret me ministrinë e linjes ku është asfaltimi dhe ndriqimi i trotuarit. Unë, mendoj që një pjesë mjaft mirë është shpalos, ndërsa pjesa tjetër që nuk është shplos ka lën hapsir që në dëgjimet buxhetore që kanë me u mbajt në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit të meren kerkesat e qytatarëve, dhe athere atyre kerkesave të j'u jepet prioritet në bazë të kerkesave të qytetarëve të cilet ata delegojnë në kuvendi komunal. Ndërsa sa i perket pyetjet për stadionin e fsh Raushiq,ky projekt është në marrveshje me ministrinë dhe jo prej komunes së Pejës. Po ashtu sa i perket për salles se sporteve në Zahaq, po ke të drejt sepse është lidh kontrata sa here por ka qenë kohë e pandemisë e cila është ndërpre për shkak se çmimet kanë qenë të larta, kontrata janë bër kur nuk është bër rritje e inflacionit dhe tash projekti është në përpunim të mësipërm kontrata është diku rreth 843 mijë euro e ketë vitë janë nda 600 mijë euro dhe ky është projekt që ka mbet borgjë për vitin 2025 se ska mundësi buxhetore të realizohet për vitin 2024.

Z.Mentor Bajri: unë mendoj që pa bashkëpunimin e ketyre tri palëve komunës, federatës së futbollit dhe ministrisë është e kot!

Znj. Xhevahire Çeku Kelemendi: unë, nuk e kam asnjë vërejtje pse o ardh Hajrije e pse nuk o ardh drejtoresha, sepse qëllimi i pyetjeve të mija është me mar përgjigjet dhe jam e sigurt që Hajrija më jep përgjigje të sakta. Unë, i kam tri pyetje buxheti për pllanton për kompleksin memorial që ka qenë e parapame në vitin 2023, dhe para dy dite janë bë 1 vitë që janë përruru dhe asnjehere nuk është ndreq pllato. Ka justifikime të shumta, që nuk ta mbulojnë dhe nuk ta mb ushin mendjen. Por as në këtë vitë nuk është parapa as në vitin 2025, gjë që ka qenë e dhimbshme për 16 qëshor që kanë shku me vendos lule me i nderu ata heronje aty! Pyetja e dytë është për fushen e sportit në Qyshk ka qenë ne PZHK, sespe pona është komunale asnjë procedurë nuk e pret vetëm vullneti. Po ashtu një pyetje për Hajrijen në ligjin për tatimin në pronë sa kam degju unë prej vitit 2024 vlerat e pronës që e kalojnë shfren mbi 300 mijë euro lirohen nga tatimi në pronë, a qendron kjo dhe sa i ndikon buxhetit për të hyrat?

Znj.Hajrije Haxhijaj: unë, nuk kam informatë në lidhje me këtë! Për qfarë prone biznes?

Znj.Xhevahire Çeku Kelmendi: është kjo varet 300-500 mijë varet a është prone biznesi.

Znj.Hajrije Haxhijaj: A është prone biznesi?

Znj.Xhevahire Çeku Kelmendi: prona banimit 300 mijë, prona biznesit që e kalon 500 mijë.

Znj.Hajrije Haxhijaj: jo është 30 mijë, ka qenë 15 mijë e tash është 30 mijë vlera.

Znj.Xhevahire Çeku Kelmendi: jo vlera e pronës që e kalon shumen prej 300 mijë lirohet prej tatimit unë e kam lexu, a qendron kjo po du me dit?

Znj.Hajrije Haxhijaj: jo vetem 30 mijshi lirohet une e thash ata te objektet zbritet norma tatimore dhe zbritet shuma ka qenë 15 mijë e tash është 30 mijë.

Z.Labinot Panxha: unë po mundohna me qit pak në temë Xhevahirin, sigurishtë e ke pas fajlen për tatimi në pronë të objekteve të gjitha kanë me u tatimu prej vitit të ardhshem, kanë me u tatimu në bazë të vlerës të cilën e kanë. Që do të thotë se nese një shtëpi në qytet e ka vleren 200 mijë euro komuna me një rregullore ka caktu se sa është në atë pjesë, vlera e asaj shtëpie dhe ajo ka me u tatimu në bazë të asaj vlere. Ndërsa në fshatra nuk është njejt tatimohet ma pak, se nese një shtëpi në fshat kushton 1 milionë euro, sepse në bazë të rregullores psh ma ka qit m2 10 euro a deshte me dal qetu Xhevahire sepse vetem kjo është kontestuse është e padrejtë.

Z.Arianit Krasniqi: sa i përket pyetjes së znj.Zize për çështjen e stadiumit te Raushiqit, ne e kemi dërgu në procedurë edhe të vlerësimit edhe të shpalljes së interesit publik. Ku e kemi pas me i marr prej pronarit privat dy parcela me realizu projektin, por ata nuk janë pajtu me çmimin dhe tash jemi mbet edhe pse i kemi nda paret për me j'a pagu, por nuk kemi mbërrri me i pagu sespe ata kanë insistu me bo një këmbim. Sipas të gjitha gjasave kemi me bo një këmbim dhe pastaj sipas procedures për me realizu projektin.

Znj.Zize Hakaja Veselaj: a janë banor të fshatit Raushiq?

Z.Arianit Krasniqi: po Besim Mulliqi, disa here e kemi pas në takim, nuk kemi mbri marrveshje.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 5 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

4.Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

Z.Nasret Hajrizi:është një raport që e kemi përfshi periudhen Qershor-Dhjetor 2023 dhe Janar – Qershor 2024, ku janë bë goxha do punë sa i perket afirizmit dhe turizmit në komunën e Pejës, dhe mendoj që me këto kapacitet që i kemi jemi duke ja dal mbanë. Natyrisht që kemi edhe pengesa gjatë rruges, sidomos pengesa pronsore që ka të bëj me zhvillimin e produkteve turistike që në njerën anë e kemi pylltarin, dhe në anën tjetër e kemi parkun nacional, dhe çdo prodhim të produkteve turistike na duhet me marr leje. Dhe nganjehere dhe nuk po e kemi lejen, mirëpo sa i perket nivelit lokal jemi mirë njëher kemi arit që të nxisim ardhjen e njerzve apo vizitorve në komunën e Pejës. Në vitin 2023 i kemi pas rreth 150 mijë vizitorë sipas agjensionit të statistikave të Kosovës janë informatat, që na dergojnë ata kohë pas kohe. Ndërsa të tjerat nese keni diqka, janë të përfshira në raport për periudhen 1 vjeqare.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit raporti (informatë) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmi në Komunën e Pejës.

5.Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi informatën rreth aktiviteteve të KKS-së, është një grup që ka obligim me i mbajt takimet së paku 6 takime në vit. Materialin e keni marr, zakonishtë nënkryetari sqaron rreth kewsaj infomate, mirëpo sot nuk e kemi prezent!

Z.Berat Ganiqi: e pash raportin dhe është procesverbal të cilin vetem e kanë përshkru në pika të shkurta. Për mua është shumë shqetësuse sepse ky është një ndër komisionet më të rëndësishme, e pash që është bisedu në pika të shkurta, dhe pak ish diskutu për shumë çështje. Për qenet endacak, për sigurinë në qytet, dhe sigurinë në komunikacion. Ndersa sa i perket komunikacionit sheshi “Haxhi Zeka” është shëndru në horror,mirëpo unë i kam dërgu email edhe shefit të komunikacionet të Republikës së Kosovës, z.Jeton Rexhepi dhe kam kërku me marr masa. Që së paku të jen 2 a 3 policë që patrollojnë naten, për me evitu rrezikun. Sepse une e di që dikush ka biznese për ato motoçikleta, mirëpo me ju bë një shirit të veqant le të jetë si në shtetet e jashtëme ku nuk ndërhyjnë këmbësorët. Çështja tjetër është se ky këshill mundet me propozu me blloku prej ora 6 deri në oren 12 të nates me blloku kalimin me vetura kah kto kafiqat që janë Fox, për një arsye aty është QKMF-ja per me shku prej kafiqit Doku e deri tek QKMF-ja eres po besoj që dikujtë kanë me ju dasht 30 minuta deri 1 orë, e me pas pacienti urgjencë. Me i lon veturat që kanë urgjencë dhe me nderpre kalimin e veturave që dalin për qejf!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe unë pajtohem te çështja e motoçikletave që të ketë një bashkëpunim me policinë.

Z.Mentor Bajri: edhe unë po pajtohem por përveq motoçikletave edhe ndalimin e ketyre instrumenteve muzikore (tupani, tarabuka) sespe po ja jepin qytetit një pamje jo të hijshme.

Z.Labinot Panxha: unë, mendoj që në kuadër të sigurisë së qytetarëve është edhe levizja e qytetarëve që e bëjnë neper trotuare e të cilat sot nese i shohim janë të bllokuara nga kafiqat. Të cilët kanë dal me tavolina dhe karrika aty, dhe kjo paraqet rrezik për qytetaret . Sepse nëse një këmbësor nuk mundet me ecë në trotuar ai është i detyruar me dal në rrugë(asfaltë) ku levizin vetura dhe paraqet rrezik për ata qytetarë. Unë, mendoj që drejtoria përkatëse me u marr ma shumë me këtë çështje dhe me i liru trotuaret të cilat janë të bllokuara me tavolina,sepse paraqet rrezik.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, i rekomandohet kuvendit raporti (informatë) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratim të propozimi vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.

Z.Arianit Krasniqi:vendimi për shpalljen e interesit publik është mar me 30.04.2019, për shpronësimin e parces me nr.254/1 ZK Raushiq me pronar Naim Fetahaj. Pronari nuk është pajtu me vleren që është bë dhe e ka padit komunën, ka shku me procedurë gjyqësore. Tani po bëhen 5 vjet që është shpallë në interes publik,komuna e ka pa të udhës që me shiku ndonjë alternativ tjetër, dhe po ashtu me procedurë gjyqësore çmimi është dyfishu. Ne e propozojmë shfuqizimin e vendimit me nr.22/2019 qëllimin e vazhimit të ndërtimit të implantit në fsh.Raushiq të cilat ne po punojmë por nuk po realizohen

Z.Berat Ganiqi: a ka dergu procedurë gjyqësore?

Z.Arianit Krasniqi: ky vetem e konteston vlerën, nuk ka drejtë me kontestu veprimin e komunes. Ai mbas shpalljes së interesit publik e padit komunën për me rrit vlerën sespe ka mendu që është dëmtu, por realisht është vlersu mjaftushem.

Z.Berat Ganiqi: a është e obligume komuna me i pagu shpenzimet procedurale?

Z.Arianit Krasniqi: nuk besoj sepse tash është vendim i gjyqësorit.

Z.Berat Ganiqi: a ka sjellë vendim gjykata?

Z.Arianit Krasniqi: jo, nuk ka sjellë vendim gjykata.

Z.Labinot Panxha: unë, mendoj që komuna nuk duhet me lëshu pe për atë të cilën ka marr vendim, sespe nëse ajo pjesë është shpallë në interes publik dhe kanë kalu 5 vitedhe 5 vite i keni blloku personit pronën. Sepse kur shpallet në interes publik ati ia keni ndalu me qit në shitje. Dhe ai e ka për qëllim me të padit ty nëse e shfuqizon këtë vendim ka me të padit për fitimin e humbur për 5 vite. Të cilën qoftë me qira dhe qoftë me shit qysh do që t'ja përcakton, mirëpo ai zotria ka me j'u padit për mjetet për fitim e humbur.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 6 votë pro, 2 votë të përmbajtur, dhe 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për miratim të propozimi vendimit për shfuqizimin e Vendimit nr.22/2019 me nr.protokolli 463-01/48816 datë 30 prill 2019 K.K. Pejë, mbi shpalljen e interesit publik.

6.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:

Z.Labinot Panxha: nëse ju kujtohet se edhe në seancën e parafundit kam kërku prej kryetarit me shku me pa një rrugë në mes të fsh.Kosuriq dhe fsh.Gllogjan, e cila quhet rruga e Tamnikut. Është një rrugë shumë e dëmtume thua e pa kalushme me automjete nuk mundem me kalu askush, ndërsa me ndonjë mjet më të rrënd kalon. Kryetari tha: se kur bëhen degjimet buxhetore publike mund me parashtu atë kërkesë dhe besoj që përfshihet aty. Unë, po e bëj këtë propozim që të bëhet rregullimi i infrastrukture në këtë rrugë, sespe si pasojë e infrastrukture së kësaj rruge të keqe kanë mbetur djerrinë mbi 100HA tokë bujqësore të fshatrave Kosuriq dhe Gllogjan.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:05 h.

**Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina**

**K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. Protokolit: 060/01-53310

Data: 09.07.2024

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

FTESË

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e VII të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet me dt. 16.07.2024 (Marte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesat.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.06.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2024.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për themelimin e grupit punuës për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2024.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2023 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2023.
9. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar. *(Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Hëne, me dt.15.07.2024).*

KRYESUESI I KPF-së
z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Komitet za Politiku i Finansije

Br. Protokola: 060/01-53310

Datum: 09.07.2024.godine

Za: Članove Komiteta za Politiku i Finansije– KPF

POZIV

Poštovani članovi,

Pozivamo vas da učestvujete na VII sednici Komiteta za Politiku i Finansije za 2024. godinu. Sednica će biti održana 16.07.2024 (u utorak) u 11:00 časova u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

Primedba: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Učešće i odsustvo članova komiteta.
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika KPF-a od 18.06.2024.
3. Razmatranje i preporuka odluke o projektu “Podrška farmerima/poljoprivrednicima u ruralnim zonama u vidu poljoprivrednih mašina”.
4. Razmatranje i preporučivanje informaciji ODO o završetku školske godine, testu postignuća i maturalnom testu.
5. Razmatranje i preporučivanje izveštaja Gradonačelnika za prvo šestomesečje 2024. Godine.
6. Razmatranje i preporučivanje osnivanja radne grupe Skupštine Opštine za 2025. Godinu.
7. Razmatranje i preporučivanje izveštaja o prihodima i rashodima za prvo šestomesečje 2024.
8. Razmatranje i preporučivanje izveštaja o reviziji godišnjih finansisjkih pregleda Opštine Peć za 2023. Gosinu i plan delovanja za nalaze revizora za 2023. Godinu.
9. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni. (Dostaviti sekretaru ne kasnije od ponedeljka, dana 15.07.2024).

PRESEDAVAJUĆI KPF-A
g. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. Protokolit: 060/01 53310

Data: 09.07.2024

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

FTESE

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e VII të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet me dt. 16.07.2024 (Marte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesat.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.06.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2024.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për themelimin e grupit punuës për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2024.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2023 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2023.
9. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar. (Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Hëne, me dt.15.07.2024).

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



KRYESUESI I KPF-së
Rexhep Kurtbogaj